



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZGJEDHJET VENDORE

30 qershor 2019

Raporti Përfundimtar

i

Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve



Varshavë
5 shtator 2019

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	1
II.	HYRJE DHE FALENDERIME.....	4
III.	SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK	4
IV.	SISTEMI ZGJEDHOR DHE KUADRI LIGJOR.....	5
V.	ADMINISTRATA ZGJEDHORE	7
A.	KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	7
B.	ADMINISTRATA ZGJEDHORE E NIVELEVE MË TË ULËTA.....	9
VI.	REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE.....	10
VII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE.....	11
VIII.	MJEDISI I FUSHATËS.....	13
IX.	FINANCIMI I FUSHATËS.....	16
X.	MEDIA	17
A.	MJEDISI I MEDIAS	17
B.	KUADRI LIGJOR	18
C.	GJETJET E MONITORIMIT TË MEDIAS.....	21
XI.	PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE	22
XII.	ANKIMET DHE APELIMET	23
XIII.	VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE	25
XIV.	DITA E ZGJEDHJEVE.....	26
XV.	ZHVILLIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE.....	28
XVI.	REKOMANDIME.....	29
A.	REKOMANDIMET KRYESORE	29
B.	REKOMANDIME TË TJERA.....	30
	SHTOJCA I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE.....	32
	SHTOJCA II: LISTA E VËZHGUESVE	34
	RRETH ODIHR-IT.....	38

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZGJEDHJET VENDORE
30 qershor 2019

Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve¹

I. PËRMBLEDHJE

Me ftesë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dërgoi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) për zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019. MVZ-ja e ODIHR-it vlerësoi përputhshmërinë e zgjedhjeve me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike dhe me legjislacionin kombëtar.

Deklarata e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake të bëra nga MVZ-ja e ODIHR-it më 1 korrik doli në përfundimin se “Zgjedhjet vendore të 30 qershorit u mbajtën pa e marrë shumë në konsideratë interesin e elektoratit. Opozita vendosi të mos marrë pjesë, kurse qeveria u tregua e vendosur për t’i mbajtur zgjedhjet pa opozitën. Në një klimë ngërçi dhe polarizimi politik, votuesit nuk patën një mundësi kuptimplotë për të zgjedhur mes disa opsioneve politike. Në 31 nga 61 bashki gjithsej, kandidatët për kryetarë bashkie garuan pa kundërshtarë. Pati pretendime të besueshme nga qytetarët për presione nga të dyja palët. Përplasjet politike çuan në pasiguri juridike dhe shumë vendime të administratës zgjedhore u morën duke pasur si objektivi politik garantimin e mbajtjes së zgjedhjeve. Votimi u zhvillua përgjithësisht në mënyrë të qetë dhe paqësore dhe numërimi u vlerësua në përgjithësi pozitivisht, ndonëse disa procedura nuk u ndoqën gjithmonë me korrektesë”.

Zgjedhjet u mbajtën në një situatë krize politike dhe institucionale, që vinte nga një antagonizëm i hershëm mes Partisë Socialiste (PS) qeverisëse dhe Partisë Demokratike (PD) në opozitë. Kjo e fundit ishte tërhequr nga Kuvendi së bashku me Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI) në muajin shkurt dhe vendosi të mos merrte pjesë në zgjedhje deri në dorëheqjen e Kryeministrit dhe formimin e një qeverie teknike. Duke shprehur shqetësime për sigurinë publike dhe përgjegjësinë e tij kushtetuese për të mbrojtur pluralizmin, më 10 qershor, Presidenti Meta nxori një dekret përmes të cilit i anulonte zgjedhjet. Kuvendi e deklaroi të pavlefshëm këtë dekret dhe ndërmori një procedurë hetimore për shkarkimin e Presidentit nga detyra. Atmosfera e ngërçit dhe e pasigurisë juridike mes institucioneve kryesore minoi besimin e publikut te legjitimiteti i zgjedhjeve.

Në muajin shkurt, filluan në Tiranë protesta të vazhdueshme të opozitës kundër Kryeministrit, të cilat u shenjua shpesh nga dhuna dhe vandalizmi i drejtuar kundër institucioneve shtetërore. Me afrimin e ditës së zgjedhjeve, protestuesit në pjesë të tjera të vendit vunë në shënjestër administratën zgjedhore, me përfshirjen shpesh të akteve të frikësimit, dhunës dhe zjarrvënies, si dhe përplasjeve mes Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit.

Kuadri ligjor mund të ofronte një bazë të shëndoshë për zgjedhje demokratike, nëse do të zbatohesh në mënyrë të paanshme dhe me një vullnet të sinqertë politik. Mungesa e dakordësisë politike që prej zgjedhjeve të vitit 2017 për Kuvendin pengoi progresin e reformës zgjedhore, duke lënë të paadresuara pjesën më të madhe të rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, përfshirë ato rekomandime që lidhen me depolitizimin e administratës zgjedhore, transparencën e financimit të fushatës dhe efikasitetin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore.

¹ Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar. Në gjuhën shqipe vihet në dispozicion përkthimi jozyrtar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) zhvilloi vazhdimisht mbledhje të hapura dhe rregulloi në mënyrë gjithëpërfshirëse aspektet e ndryshme të procesit zgjedhor. Ekuilibri politik i parashikuar me ligj brendapërbrenda administratës zgjedhore nuk mundi të arrihej për shkak të vendimit fillestar të partive kryesore opozitare për të mos propozuar komisionerë, si dhe interpretimit të mëvonshëm të KQZ-së se vetëm ato parti parlamentare që garojnë në zgjedhje mund të përfaqësohen në administratën zgjedhore. Përbërja e paekuilibruar politikisht e administratës zgjedhore dhe thirrja e partive opozitare drejtuar zgjedhësve për të bojkotuar zgjedhjet e minuan më tej besimin e publikut te procesi.

Asnjë bashkëbisedues i MVZ-së së ODIHR-it nuk ngriti shqetësime rreth plotësisë dhe saktësisë së listave të zgjedhësve. Megjithatë, zgjedhësit e shpallur me vendim gjykatë si persona që nuk kanë zotësinë për të vepruar, si dhe personat që nuk kanë shtetësinë shqiptare, pavarësisht kohës që kanë jetuar në vend, nuk kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet vendore. Përveç kësaj, disa bashkëbisedues ngritën pikëpyetje rreth cilësisë së procesit të verifikimit të të dhënave të adresave. Listat e zgjedhësve u afishuan fillimisht në ambientet e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV), siç kërkohet me ligj, por u hoqën në mes të muajit qershor në pjesën më të madhe të bashkive të qeverisura nga opozita, duke e kufizuar në këtë mënyrë mundësinë e zgjedhësve për të verifikuar të dhënat e tyre.

KQZ-ja demonstroi qartazi një qasje gjithëpërfshirëse në regjistrimin e kandidatëve, gjë që rriti numrin e garuesve. Megjithatë, KQZ-ja e interpretoi ligjin në mënyrë jokonsistente dhe tejet të gjerë, duke ulur sigurinë juridike. Në total, u regjistruan 97 kandidatë për kryetar bashkie dhe 544 lista kandidatësh për këshillat bashkiakë në të 61 bashkitë. Megjithatë, zgjedhësit nuk patën një mundësi të plotë zgjedhjeje mes alternativave kryesore politike, duke qenë se partitë kryesore opozitare nuk morën pjesë në këto zgjedhje.

Sistemi i kuotave për regjistrimin e kandidatëve ka krijuar një mjedis të favorshëm për pjesëmarrje më të madhe të grave në jetën politike. U regjistruan vetëm listat e kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë që përfshinin 50 përqind të secilës gjini, duke çuar në 44 përqind të mandateve për anëtarë të këshillave bashkiakë të fituara nga gratë në këto zgjedhje. 11 gra garuan për kryetare bashkie dhe 8 (13 përqind) prej tyre u zgjodhën kryetare bashkie. Megjithatë, janë të pakta gratë që mbajnë role drejtuese në partitë politike. Me disa përjashtime, politikanet gra nuk spikatën ndjeshëm në fushatë apo në protestat e opozitës. Dy nga pesë anëtarët e KQZ-së dhe 37 përqind të anëtarëve të KZAZ-ve ishin gra.

Vizibiliteti i aktiviteteve të fushatës ishte i ulët, me përjashtim të atyre mitingjeve të PS-së ku folësi kryesor ishte Kryeministri. Ndonëse çështjet lokale u adresuan në disa takime të vogla, fokusi u vu tek mospjesëmarrja e partive kryesore opozitare dhe tek anulimi i zgjedhjeve. Gjuha e përdorur nga kundërshtarët politikë në mitingje, në mediat sociale dhe në median e shkruar dhe atë audiovizive ishte shpesh e ndezur dhe e mbushur me akuza dhe kundërakuzat. Qytetarët, sidomos ata që punonin në administratën publike, u përballën me presione për të shfaqur preferencat e tyre politike. Me një numër të vogël garuesish dhe shumë gara pa kundërshtarë, zgjedhja që iu vu përpara në thelb qytetarëve ishte nëse duhet apo nuk duhet të merrnin pjesë në zgjedhje.

Fushatat mund të financohen nga burime publike dhe private, ndërkohë që për dhurimet dhe shpenzimet janë vendosur disa kufij. Në një zhvillim pozitiv, KQZ-ja miratoi disa udhëzime dhe formularë të standardizuar raportimi dhe organizoi trajnime për partitë politike dhe kandidatët për kryetar bashkie për rritjen e transparencës së fushatës zgjedhore. KQZ-ja emëroi ekspertë financiarë për verifikimin e shpenzimeve të fushatës, të cilët publikuan raporte javore, megjithëse ato ndryshonin njëri nga tjetri për nga konsistenca dhe shkalla e qëmtimit.

Mediat janë të larmishme, por mbeten të varura nga pozicionimet politike dhe interesat e biznesit të pronarëve të tyre. Në mungesë të një vetërregullimi efikas, gazetarët operojnë në kushte të pasigurta pune dhe shpesh u duhet të zgjedhin autocensurën. Media transmetuese u fokusua në një masë të madhe të kriza politike dhe institucionale, sidomos tek shkëmbimet e nxehta mes PD-së dhe PS-së. Mbulimi i kufizuar i fushatës u fokusua te Kryeministri aktual, i cili drejton PS-në dhe prezantoi kandidatët në terren, si dhe te kryetari aktual i bashkisë Tiranë (PS). Praktika e ndjekur nga PS-ja dhe zyrtarët, duke i ofruar medias filmime nga aktivitetet zyrtare dhe ato të fushatave ndërkohë që medias i kufizua aksesin në to, e ngushtoi mundësinë e zgjedhësve për të marrë informacione objektive.

Ligji u garanton të drejtën për të votuar dhe për të kandiduar në zgjedhje të gjithë qytetarëve, pavarësisht origjinës së tyre etnike, racës, besimit fetar apo gjuhës. Bashkëbisedues të ndryshëm të MVZ-së së ODIHR-it raportuan se anëtarët e komunitetit rom janë veçanërisht të cenusur nga problemet me regjistrimin e zgjedhësve, për shkak të mungesës së një adrese të përhershme. Disa parti të pakicave kombëtare vendosën të mos marrin pjesë në zgjedhje, duke ua kufizuar zgjedhësve mundësinë e zgjedhjes. MVZ-ja e ODIHR-it nuk konstatoi ndonjë material zgjedhor të prodhuar nga KQZ-ja në gjuhët e pakicave.

Mosmarrëveshjet zgjedhore u zgjidhën nga KQZ-ja dhe nga gjykata brenda afateve të parashikuara ligjore, por nuk u garantua gjithmonë në kohën e duhur aksesin në vendimet e tyre dhe njoftimi i palëve përkatëse. Kjo cenon transparencën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe nuk shërben për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi rregullat e procesit zgjedhor. Gjykata e ngushtoi legjitimitimin e garuesve në mosmarrëveshjet lidhur me regjistrimin e kandidatëve, duke i lënë kështu palët e prekura nga kjo pa zgjidhje efektive.

Ligji parashikon praninë e vëzhguesve vendas e ndërkombëtarë si dhe vëzhguesve të partive politike në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore, por vetëm këta të fundit kanë të drejtë të marrin kopje të rezultateve të numërimit dhe të përpunimit të votave në vendet e numërimit. KQZ-ja akreditoi 630 vëzhgues vendas, por disa OJQ u tërhoqën nga aktivitetet për edukimin e zgjedhësve dhe vëzhgimin e zgjedhjeve për të shmangur perceptimin se po shprehnin preferenca politike përmes angazhimit në procesin zgjedhor.

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht paqësore, me disa protesta dhe përplasje të izoluara në disa komunitete. Pjesëmarrja në zgjedhje varioi nga një bashki në tjetrën, ndërkohë që shifra zyrtare e komunikuar nga KQZ-ja ishte 22.96 përqind. Prania e vëzhguesve të partive, kryesisht atyre të PS-së, u vu re gjatë të gjitha fazave të procesit zgjedhor, ndërkohë që vëzhguesit vendas të pranishëm ishin më të pakët në numër. Hapja e qendrave të votimit dhe procesi i votimit u vlerësuan pozitivisht nga MVZ-ja e ODIHR-it në pjesën më të madhe të qendrave të vëzhguara të votimit; megjithatë, votimi në grup, përfshirë votimin familjar, u vërejt në 10 përqind të vëzhgimeve. Pothuajse dy të tretat e qendrave të vëzhguara të votimit nuk lejuan aksesin e pavarur të zgjedhësve me aftësi të kufizuar. Numërimi dhe nxjerrja e rezultateve u vlerësuan pozitivisht, ndonëse disa procedura nuk u ndoqën gjithmonë me korrektesë.

Komentet e bëra nga aktorët kryesorë politikë pas zgjedhjeve reflektuan sërish përçarje të thella, dhe disa kryetarë aktualë bashkie deklaruan publikisht se nuk do të pranonin rezultatet e votimit të 30 qershorit dhe se do të vazhdonin të qëndronin në detyrë. KQZ-ja mori kërkesa për shpalljen të pavlefshme të rezultateve të zgjedhjeve në më shumë se 40 bashki, kryesisht për shkak të diferencave të pretenduara mes pjesëmarrjes zyrtare në zgjedhje dhe të dhënave të raportuara nga vëzhguesit e partive politike. KQZ-ja i hodhi poshtë të gjitha këto ankime, kryesisht për shkak të mungesës së provave. Ndarja e mandateve për të gjitha 61 këshillat vendorë u krye nga Kolegji Zgjedhor, për shkak të mosarritjes nga ana e KQZ-së të shumicës së cilësuar që kërkon ligji për vendimmarrje për ndarjen e tyre. Më 27 korrik, KQZ-ja miratoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

Ky raport ofron rekomandime në mbështetje të përpjekjeve për harmonizimin e mëtejshëm të procesit zgjedhor në Shqipëri me angazhimet e OSBE-së dhe me detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Rekomandimet kryesore kanë të bëjnë me angazhimin e aktorëve zgjedhorë në një dialog gjithëpërfshirës për reformën zgjedhore, duke u garantuar zgjedhësve të drejtën për të zgjedhur në mënyrë të lirë dhe të fshehtë, duke eliminuar problemin e hershëm të shpërdorimit të burimeve administrative, duke rritur pavarësinë dhe paanshmërinë e administratës zgjedhore dhe të gjyqësorit, si dhe për hetime efikase të shkeljeve zgjedhore. ODIHR-i mbetet i gatshëm për t'i asistuar autoritetet në përmirësimin e procesit zgjedhor dhe në adresimin e rekomandimeve që përmban ky raport dhe raporte të mëparshme të tij.

II. HYRJE DHE FALENDERIME

Me ftesë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për vëzhgimin e zgjedhjeve vendore të 30 qershorit dhe duke u bazuar në rekomandimin e Misionit të Vlerësimit të Nevojave të realizuar nga 19 deri më 21 mars, ODIHR-i dërgoi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) më 23 maj. E kryesuar nga Ambasadorja Audrey Glover, MVZ-ja përbëhej nga 14 ekspertë të vendosur në Tiranë dhe 18 vëzhgues afatgjatë, të cilët u vendosën në të gjithë vendin prej datës 1 qershor. Në ditën e zgjedhjeve, u angazhuan 174 vëzhgues nga 33 vende. Misioni qëndroi në Shqipëri deri më 12 korrik për të ndjekur zhvillimet pas zgjedhjeve.

MVZ-ja e ODIHR-it vlerësoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor me angazhimet e OSBE-së dhe me detyrimet e tjera ndërkombëtare dhe standardet për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin kombëtar. Ky raport përfundimtar vjen pas Deklarimit të Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake, të cilat u bënë të njohura në një konferencë për shtyp në Tiranë më 1 korrik.²

MVZ-ja e ODIHR-it dëshiron të falënderojë autoritetet për ftesën për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. Ajo shpreh gjithashtu vlerësimin për përfaqësuesit e institucioneve të tjera kombëtare e lokale, administratës zgjedhore, partive politike, shoqërisë civile, medias, komunitetit ndërkombëtar dhe bashkëbiseduesve të tjerë për ndarjen e pikëpamjeve të tyre.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Në nëntor 2018, në përputhje me Kushtetutën, Presidenti Ilir Meta shpalli me dekret mbajtjen e zgjedhjeve vendore më 30 qershor. Duke iu referuar shqetësimeve për sigurinë publike dhe përgjegjësisë së tij kushtetuese për mbrojtjen e pluralizmit, Presidenti e shfuqizoi atë dekret më 10 qershor. Më 13 qershor, Kuvendi miratoi një rezolutë ku e shpallte shfuqizimin të pavlefshëm, dhe më 19 qershor nisi një procedurë të ndërmarrë nga Partia Socialiste (PS) për shkarkimin e Presidentit për tejkalim të kompetencave të tij.³ Më 27 qershor, Presidenti Meta nxori një tjetër dekret, duke përcaktuar si datë të zgjedhjeve vendore datën 13 tetor 2019.⁴ Gjatë kësaj periudhe, KQZ-ja vazhdoi përgatitjet për mbajtjen e zgjedhjeve më 30 qershor.

Mjedisi politik përpara zgjedhjeve ishte i polarizuar dhe antagonist. Në muajin shkurt, Partia Demokratike (PD) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) të opozitës hoqën dorë nga mandatet e

² Shih [të gjitha raportet e mëparshme të ODIHR-it për zgjedhjet në Shqipëri](#).

³ [Rezoluta](#) e Parlamentit e akuzonte, ndër të tjera, Presidentin, për shkelje të parimit të periodicitetit të zgjedhjeve dhe të së drejtës së qytetarëve për të zgjedhur.

⁴ Ndryshe nga dekreti i 10 qershorit, dekreti i Presidentit i datës 27 qershor mbeti i papublikuar në Fletoren Zyrtare, ndonëse publikimi i akteve të lëshuara nga Presidenti kërkohet me ligj.

tyre parlamentare pas hedhjes poshtë nga Kuvendi të nismës së tyre për *vetting*-un e politikanëve. Ndjekur nga disa parti më të vogla, PD-ja dhe LSI-ja bënë të ditur se nuk do të merrnin pjesë në zgjedhje deri në dorëheqjen e Kryeministrit Edi Rama (kryetar i PS-së) dhe krijimin e një qeverie tranzicioni që do të organizonte zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin.⁵ Në muajin shkurt, në Tiranë filluan protesta të vazhdueshme të opozitës, të drejtuara nga PD-ja, të cilat u shenjua shpesh nga dhuna dhe vandalizmi ndaj institucioneve shtetërore, duke përfshirë edhe selinë e Kryeministrit.

Kryeministri i hodhi poshtë kërkesat e opozitës dhe, duke paralajmëruar se ishte kundër krijimit të një precedenti që do të kërcënonte atë çka ai e përshkroi si “bashkëjetesë demokratike” të qeverive të zgjedhura dhe të opozitave të tyre parlamentare, deklaroi se zgjedhjet do të mbaheshin siç ishin planifikuar.⁶

Kriza politike u intensifikua me afrimin e ditës së zgjedhjeve. Nga mesi i qershorit, pothuajse të gjithë kryetarët e bashkive të opozitës e informuan KQZ-në se do të respektonin dekretin e 10 qershorit dhe do t'u jepnin fund të gjitha përgatitjeve zgjedhore.⁷ Në disa prej këtyre bashkive, protestat vunë në shënjestër administratën zgjedhore, duke përfshirë shpesh edhe akte frikësimi, dhune, zjarrvënijeje, si dhe konfrontime midis Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit. Shumë aktorë vendas dhe partnerë ndërkombëtarë në vend bënë thirrje për dialog për zgjidhjen e krizës politike, por partitë politike treguan përgjithësisht një vullnet të pakët për t'u angazhuar në një bashkëpunim konstruktiv.⁸ Ky antagonizëm ishte tregues i mungesës së një përgjegjësie të përbashkët për të garantuar integritetin e një procesi zgjedhor që do të shkonte përtej ndarjeve partiake dhe ndikoi, rrjedhimisht, negativisht në të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisje.

Pas rekomandimit të 29 majit të Komisionit Evropian për hapjen e negociatave me Shqipërinë për aderimin e saj në Bashkimin Evropian, më 18 qershor Këshilli Evropian e shtyu vendimmarrjen për në tetor 2019.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR DHE KUADRI LIGJOR

Zgjedhjet u mbajtën për 61 kryetarë bashkish dhe 1,619 anëtarë të këshillave bashkiake gjithsej në të gjithë vendin. Kryetarët e bashkive dhe anëtarët e këshillave bashkiakë zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për një mandat katër-vjeçar. Kryetarët e bashkive zgjidhen përmes një sistemi mazhoritar, kurse këshilltarët zgjidhen sipas një sistemi proporcional me lista të mbyllura. Territorët e bashkive përfaqësojnë zonat zgjedhore për zgjedhjet vendore. Legjislacioni nuk përmban asnjë dispozitë specifike për zhvillimin e zgjedhjeve pa kundërshtarë dhe asnjë kufi të pjesëmarrjes minimale të zgjedhësve si kriter për vlefshmërinë e rezultateve. Numri i anëtarëve të këshillave bashkiakë që zgjidhen në çdo bashki përcaktohet në bazë të popullsisë, dhe varion nga 15 në 61.

⁵ Para zgjedhjeve, PS-ja kishte pozicionet e kryetarëve të bashkive në 33 bashki; Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Evropian (AMIE) dhe Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen (MEGA) kishte secila nga një kryetar bashkie. Partitë opozitare kishin postin e kryetarit të bashkisë në 26 bashki, përfshirë kryetarët e bashkisë të PD-së në 16 bashki (Devoll, Dropull, Kamëz, Kavajë, Klos, Kukës, Lezhë, Mallakastër, Mat, Përmet, Pogradec, Selenicë, Shkodër, Tropojë, Vau i Dejës dhe Vorë), kryetarët e bashkisë të LSI-së në 8 bashki (Berat, Bulqizë, Cërrik, Delvinë, Gjirokastrë, Kuçovë, Skrapar dhe Përrenjas), dhe kryetarë bashkie të PDIU-së në Peqin dhe Rrogozhinë.

⁶ Shih ‘[Letrën e Shtatë](#)’ të Kryeministrit, të datës 1 qershor.

⁷ Kryetari i Bashkisë së Bulqizës (LSI) ishte i vetmi kryebashkiak i opozitës që nuk e informoi KQZ-në se administrata lokale nuk do të lejonte mbajtjen e zgjedhjeve më 30 qershor.

⁸ Shih parimet e përgjithshme të Komisionit Evropian të Këshillit të Evropës për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) [Parametrat e Marrëdhënieve midis shumicës dhe opozitës parlamentare në demokraci: Listë kontrolli](#), Listë kontrolli CDL-AD(2019)015 (24 qershor), f. 7-8.

Për t'u kualifikuar për ndarjen e mandateve, partitë duhet të kalojnë një prag prej tre përqind të votave të hedhura në bashkinë përkatëse, kurse koalicionet duhet të kalojnë një prag prej pesë përqind.⁹ Mandatet e këshillave vendorë ndahen mes partive dhe koalicioneve sipas metodës d'Hondt, kurse shpërndarja e mandateve mes partive brenda një koalicioni bëhet duke përdorur metodën Sainte-Laguë.¹⁰

Zgjedhjet vendore administrohen kryesisht në bazë të Kushtetutës së vitit 1998 (ndryshuar për herë të fundit në vitin 2016), Kodit Zgjedhor të vitit 2008 (ndryshuar për herë të fundit në vitin 2015), Ligjit për Partitë Politike të vitit 2000 (ndryshuar për herë të fundit në vitin 2017), Ligjit për Garantimin e Integritetit të Personave të Zgjedhur, të Emëruar ose që Ushtrjnë Funksione Publike të vitit 2015 (i ashtuquajtur "Ligji i Dekriminalizimit"), Ligji për Tubimet i vitit 2001, Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri i vitit 2008, Ligji për Median Audio-vizuale i vitit 2013, dispozitave përkatëse të Kodit Penal të vitit 1995 dhe Kodit të Procedurave Administrative të vitit 2015, si dhe akteve të KQZ-së dhe vendimeve të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit të Tiranës (Kolegji Zgjedhor). Shqipëria është palë e instrumenteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.¹¹

Në një përpjekje për të adresuar rekomandimet e kaluara të MVZ-ve të ODIHR-it, u ringrit në nëntor të vitit 2017 një Komision i Posaçëm parlamentar për Reformën Zgjedhore, i bashkëkryesuar nga përfaqësuesit e PD-së dhe PS-së, për përgatitjen e ndryshimeve të nevojshme. Ndonëse ky komision kishte një mandat teknik dhe ndoqi një qasje gjithëpërfshirëse dhe të bazuar tek konsensusi, puna e tij u bllokua nga opozita në dhjetor të vitit 2018, dhe reforma zgjedhore mbeti në vend për shkak të mungesës së një marrëveshjeje politike. Rrjedhimisht, pjesa më e madhe e rekomandimeve të MVZ-ve të ODIHR-it mbeten të paadresuara, duke përfshirë edhe ato që i përkasin depolitizimit të administratës zgjedhore, dekriminalizimit të shpifjes dhe efikasitetit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore. Ajo çka përbën një zhvillim pozitiv është se, në datën 10 maj, qeveria miratoi dy vendime që kishin për qëllim parandalimin e shpërdorimit të administratës dhe burimeve publike gjatë zgjedhjeve.¹²

Kuadri ligjor për zgjedhjet, ndonëse i pandryshuar në pjesën më të madhe që prej zgjedhjeve të fundit, mund të përbënte përgjithësisht një bazë të shëndoshë për zgjedhje demokratike. Pavarësisht kësaj, mungesa e qartësisë së disa dispozitave, si p.sh. në lidhje me të drejtën e partive për mosmbledhjen e firmave mbështetëse apo mbi statusin e partive parlamentare, lejuan perceptime njëanshmërie në zbatimin e tyre nga KQZ-ja. Aktorët zgjedhorë nuk demonstuan gjithmonë vullnet politik për të

⁹ Një kandidat i pavarur fiton një vend në këshill nëse numri i votave për të është më i madh se kuota minimale e përcaktuar për ndarjen e mandateve për partitë dhe koalicionet.

¹⁰ Kur voton për një koalicion, zgjedhësi zgjedh një prej partive përbërëse të koalicionit, duke shprehur në këtë mënyrë preferencën e tij. Numri i votave individuale për një parti brenda një koalicioni përcakton numrin e mandateve që i caktohen kësaj partie nga numri total i mandateve të fituara nga ai koalicion në një zonë të caktuar zgjedhore.

¹¹ Përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) të vitit 1966, Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial të vitit 1965, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) të vitit 1979, Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrues dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre të vitit 1990, Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit të vitit 2003, Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD) të vitit 2006, si dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1950 dhe Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare të vitit 1998. Shqipëria është gjithashtu anëtare e Komisionit të Venecias dhe Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

¹² Shih Vendimet e Këshillit të Ministrave të datës 10 maj [Për masat dhe aktivitetin monitorues, përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të vitit 2019](#) dhe [Për pezullimin e përkohshëm të fillimit të procedurave të prokurimit nga bashkitë nga data 1 deri më 30 qershor 2019](#).

zbatuar si duhet dispozitat ligjore, duke përfshirë rastet e propozimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore dhe gjatë procesit të regjistrimit të kandidatëve.

Me qëllim forcimin e demokracisë pluraliste, rikonfirmimin e të drejtës së qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisje dhe demonstrimin e përgjegjësisë së përbashkët për integritetin e procesit zgjedhor, partitë politike dhe aktorët e tjerë zgjedhorë duhet të angazhohen në një dialog të hapur dhe gjithëpërfshirës dhe të lehtësojnë reformën zgjedhore për adresimin e rekomandimeve që përmban ky raport dhe raportet e mëparshme të ODIHR-it.

Atmosfera e pasigurisë dhe ngërçit mes institucioneve kyçe cenoi besimin e publikut te legjitimiteti i zgjedhjeve. Kjo pasiguri u rëndua edhe më shumë nga mosmarrëveshja mes aktorëve zgjedhorë në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë mes Gjykatës Kushtetuese, si i vetmi organ i mandatuar për të vendosur në lidhje me kushtetutshmërinë e dekreteve të Presidentit, dhe Kolegjit Zgjedhor, që është i mandatuar për të mbikëqyrur ligjshmërinë e procesit zgjedhor. Gjykata Kushtetuese është përkohësisht jofunksionale për shkak të "vetting-ut të gjyqësorit", një proces disa vjeçar në shkallë vendi për rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri, që është në vazhdim e sipër.

V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Administrata zgjedhore përbëhet nga tre nivele: KQZ-ja, 90 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe 5,417 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi kryhet nga Grupet e Numërimit në 90 Vende të Numërimit të Votave (VNV), një për secilën Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ).¹³ Dy nga pesë anëtarët e KQZ-së dhe 37% e anëtarëve të KZAZ-ve ishin gra. Ndonëse gratë përbënin 25 përqind të anëtarëve të KQV-ve të vëzhguara në ditën e zgjedhjeve, duke përfshirë edhe 19 përqind të kryetarëve, 40 përqind e qendrave të votimit të vëzhguara nuk kishin asnjë komisionere grua.¹⁴

Ligji parashikon mundësi të barabarta përfaqësimi për partitë parlamentare në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Më parë, ODIHR-i ka rekomanduar lejimin e emërimeve jopartiake të komisionerëve zgjedhorë me qëllim depolitizimin e administratës zgjedhore. Në këtë proces zgjedhor, këto të drejta u përdorën nga partitë për manovra politike në kurriz të paanshmërisë së administratës zgjedhore. Mospranimi nga ana e partive opozitare për të propozuar anëtarët e tyre në KQZ dhe KZAZ, bashkë me interpretimin më pas nga KQZ-ja të ligjit se vetëm ato parti parlamentare që marrin pjesë në zgjedhje mund të propozojnë anëtarë, e la administratën zgjedhore të paeqilibruar politikisht. Rrjedhimisht, shumë prej bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën mungesë besimi tek të gjitha nivelet e komisioneve.

Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, për të rritur besimin e publikut te procesi zgjedhor, duhet parë mundësia e gjetjes së formulave alternative për propozimin e anëtarëve në administratën zgjedhore, mbështetur me garanci procedurale për pavarësinë e tyre.

A. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

¹³ Si rregull, ZAZ-të korrespondojnë me territorin e bashkive. Në 10 bashki (Durrës, Elbasan, Fier, Kamëz, Korçë, Lezhë, Lushnjë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë) që kanë më shumë se 80,000 zgjedhës, ngrihen ZAZ shtesë. Në këto bashki, regjistrimi i kandidatëve dhe proceset e nxjerrjes së rezultateve administrohen nga KQZ-ja.

¹⁴ Kryetari i një KZAZ-je e informoi MVZ-në e ODIHR-it se të punuarit për shumë orë, kushtet e vështira të punës, si dhe vendndodhjet e largëta të qendrave të votimit kontribuuan që të gjitha në nivelin e ulët të përfaqësimit të grave si anëtare të KQV-ve.

KQZ-ja është një organ i përhershëm i zgjedhur nga Kuvendi. Sipas ligjit, ajo përbëhet nga shtatë anëtarë: tre të propozuar nga shumica parlamentare dhe tre të propozuar nga opozita parlamentare,¹⁵ dhe nga kryetari që zgjidhet nga Kuvendi përmes një procesi të hapur aplikimi. Gjatë këtyre zgjedhjeve, KQZ-ja përbëhet nga pesë anëtarë, duke përfshirë edhe kryetarin i cili nga ana formale nuk i përket asnjë partie, ku tre anëtarë ishin të propozuar nga PS-ja dhe një nga Partia Republikane.¹⁶ PD-ja nuk i ka plotësuar vendet e saj për dy anëtarë që prej tetorit të vitit 2018.

KQZ-ja është e ngarkuar me kryerjen e zgjedhjeve në tërësi. Ajo ka një mandat dhe gamë të gjerë përgjegjësisë, duke përfshirë nxjerrjen e vendimeve detyruese, regjistrimin e partive dhe koalicioneve, trajnimin e komisioneve të niveleve më të ulëta, shqyrtimin e ankimeve, monitorimin e financimit të fushatës dhe akreditimin e vëzhguesve ndërkombëtarë dhe vendas.

KQZ-ja zhvilloi rregullisht mbledhje të hapura, të transmetuara drejtpërdrejt *online* dhe të ndjekura nga vëzhgues dhe nga media, si dhe rregulloi në mënyrë gjithëpërfshirëse aspektet e ndryshme të procesit zgjedhor. Duke mbetur brenda kompetencave të saj ligjore, KQZ-ja e zbatoi ligjin në disa raste në mënyrë jokonsistente ose në një mënyrë që shfaqte njëanshmëri (shih *Regjistrimin e Kandidatëve*).¹⁷ Disa vendime të KQZ-së, duke përfshirë ato për mosregjistrimin e kandidatëve dhe disa vendime lidhur me ankimet, u publikuan me vonesa të konsiderueshme, gjë që dëmtoi transparencën.¹⁸

Për rritjen e transparencës së punës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të publikojë në kohë dhe në mënyrë sistematike të gjitha vendimet e tij në faqen e tij zyrtare.

KQZ-ja miratoi udhëzime për administrimin e procesit të votimit dhe numërimit në kohën e duhur dhe organizoi trajnimin e KZAZ-ve dhe KQV-ve. Materialet e trajnimit ishin të hartuara mirë dhe MVZ-ja e ODIHR-it i vlerësoi përgjithësisht pozitivisht seancat e trajnimit, por evidentoi në disa raste pjesëmarrje të ulët. KQZ-ja hartoi gjithashtu materiale gjithëpërfshirëse për edukimin e zgjedhësve, duke përfshirë ato lidhur me procedurat në ditën e zgjedhjeve dhe në lidhje me përgjegjësitë penale për shkelje të dispozitave lidhur me zgjedhjet. Materialet në formë videoje të nxjerra nga KQZ-ja, të cilat përfshinin edhe shpjegimin në gjuhën e shenjave, u transmetuan në kanale të ndryshme televizive kombëtare.

Dekreti i Presidentit i 10 qershorit u konsiderua absolutisht i pavlefshëm nga shumica e anëtarëve të KQZ-së.¹⁹ Në bashkitë e drejtuara nga kryetarët e PS-së, përgatitjet për zgjedhjet vazhduan sipas

¹⁵ Partia më e madhe e shumicës parlamentare dhe e opozitës parlamentare propozojnë secila nga dy anëtarë të KQZ-së. Përveç tyre, partia e dytë për nga madhësia e shumicës parlamentare dhe e opozitës parlamentare propozojnë nga një anëtar secila.

¹⁶ Zëvendëskryetari aktual i KQZ-së është ish-kryetari i saj dhe është propozuar për në KQZ për vendin që i takonte Partisë Republikane. Ai u bë zëvendëskryetar i KQZ-së si rrjedhojë e një marrëveshjeje politike në vitin 2017.

¹⁷ Duke mos pranuar kërkesën e opozitës për zëvendësimin e anëtarëve të KZAZ-ve të emëruar nga KQZ-ja kryesisht, KQZ-ja nxori një vendim "individual", i cili miratohet me votën e shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij. Këtij vendimi iu dha më pas efekt "normativ", duke qenë se KQZ-ja i udhëzoi KZAZ-të të mos praninin të propozuarit nga PD-ja dhe LSI-ja as për në KQV dhe Grupet e Numërimit. Vendimet e KQZ-së që kanë karakter normativ kërkojnë shumicën e dy të tretave të anëtarëve. Sipas [Kodit të praktikave të mira për çështjet zgjedhore](#) të vitit 2002 të Komisionit të Venecias, "Është e dëshirueshme që komisionet zgjedhore të marrin vendime me shumicë të cilësuar ose me konsensus".

¹⁸ Paragrafi 68 i Raportit Shpjegues të "Kodit të praktikës së mirë në çështje zgjedhore" të vitit 2002 të Komisionit të Venecias përcakton se "Vetëm transparenca, paanshmëria dhe pavarësia nga manipulimet e motivuara politikisht garantojnë administrimin si duhet të procesit zgjedhor, nga periudha parazgjedhore deri në fund të përpunimit të rezultateve".

¹⁹ Qëndrimi i KQZ-së në lidhje me pavlefshmërinë e dekretit të Presidentit u shpreh në vendimin e saj të datës 13 qershor për mospranimin e kërkesës së Partisë së Unitetit Kombëtar për t'u tërhequr nga zgjedhjet. Më vonë, Kolegji Zgjedhor e la në fuqi vendimin e KQZ-së.

planit. Në pothuajse të gjitha bashkitë e drejtuara nga opozita, kryetarët e bashkive i urdhëruan KZAZ-të të ndërprisnin përgatitjet dhe të lironin ambientet e bashkive.²⁰ Si rrjedhojë, KQZ-së iu desh të zhvendoste më shumë se 200 qendra votimi, si dhe disa KZAZ dhe VNV. Thirrjet e opozitës drejtuar elektoratit për bojkotimin e zgjedhjeve, njëanshmëritë politike të autoriteteve bashkiake dhe përbërja e paekuilibruar e administratës zgjedhore ndikuan që të gjitha negativisht te besimi i publikut në procesin zgjedhor.

B. ADMINISTRATA ZGJEDHORE E NIVELEVE MË TË ULËTA

Me ligj, KZAZ-të emërojnë anëtarët e KQV-ve dhe Grupeve të Numërimit përkatëse, shpërndajnë materialet zgjedhore dhe shqyrtojnë ankesat ndaj KQV-ve dhe Grupeve të Numërimit. KZAZ-të janë gjithashtu të ngarkuara me regjistrimin e kandidatëve dhe me nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve në nivel vendor, me përjashtim të rasteve kur këto funksione kryhen nga KQZ-ja.

KZAZ-të përbëhen nga shtatë anëtarë dhe një sekretar pa të drejtë vote, që të gjithë të emëruar nga KQZ-ja për çdo zgjedhje. Formula e propozimit është e ngjashme me atë për KQZ-në, ku shumica dhe opozita parlamentare propozojnë nga tre anëtarë secila në të gjitha KZAZ-të si dhe anëtarin e shtatë në gjysmën e KZAZ-ve.²¹ Ndërkohë që PS-ja propozoi komisionerë në të gjitha KZAZ-të, PD-ja dhe LSI-ja nuk paraqitën asnjë propozim brenda afateve ligjore, duke e shtyrë kështu KQZ-në të kryente emërimin e këtyre anëtarëve kryesisht dhe duke i lënë të gjitha KZAZ-të pa anëtarë të propozuar nga opozita.²² Si rrjedhojë, në 45 KZAZ, PS-ja kishte katër komisionerë, duke përfshirë kryetarët.²³ 45 KZAZ-të e tjera kishin tre komisionerë të propozuar nga PS-ja, një komisioner të emëruar nga KQZ-ja kryesisht dhe operuan pa kryetarë.²⁴

Sipas ligjit, anëtarët e KZAZ-ve të emëruar nga KQZ-ja mund të zëvendësoheshin nga anëtarët që do të propozonin partitë politike para 31 majit. Më 20 maj, PD-ja dhe LSI-ja paraqitën një kërkesë për zëvendësimin e anëtarëve të KZAZ-ve të emëruar nga KQZ-ja kryesisht. Në interpretimin e saj të dispozitave me përmbajtje të ndryshme të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja e lidhi të drejtën e partive parlamentare për të propozuar komisionerë me regjistrimin e tyre si subjekte zgjedhore, dhe vendosi që ato parti që nuk ishin regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhje kishin hequr dorë nga e drejta e tyre për të propozuar komisionerë në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore.²⁵

KQV-të janë përgjegjëse për organizimin e votimit në ditën e zgjedhjeve, si dhe për paketimin dhe transportimin e fletëve të votimit dhe materialeve të tjera zgjedhore pas votimit në VNV-të përkatëse,

²⁰ Në disa bashki, kjo u pasua me përpjekje për nxjerrjen e organeve të administrimit të zgjedhjeve nga ambientet e tyre. Në Kamëz, Kavajë, Klos, Kukës, Mat, Shkodër, Tropojë dhe Vorë, kjo çoi në përplasje të dhunshme, zjarrvënie dhe shkatërrim të materialeve zgjedhore dhe ambienteve. Shumë administrata bashkiake njoftuan se do të zhvillonin aktivitete kulturore në ambientet e votimit dhe numërimit në prag të zgjedhjeve dhe në vetë ditën e zgjedhjeve.

²¹ Tre anëtarë duhet të ishin propozuar nga PS-ja, dy nga PD-ja dhe një nga LSI-ja. PD-ja dhe PS-ja mund të propozojnë gjithashtu edhe anëtarin e shtatë në 45 KZAZ secila. Në gjysmën e KZAZ-ve, kryetari është i propozuar nga PS-ja, kurse në gjysmën tjetër nga PD-ja. Zëvendëskryetari dhe sekretari i përkasin partisë kryesore politike që nuk ka propozuar kryetarin në KZAZ-në përkatëse.

²² Kodi Zgjedhor ofron mekanizma alternativë për propozimin e komisionerëve në rast se kjo nuk bëhet nga subjektet që kanë të drejtën e propozimit. Më 18 mars, KQZ-ja publikoi një thirrje të hapur për qytetarët për plotësimin e vendeve bosh në KZAZ. Sipas udhëzimit të KQZ-së, nëse numri i aplikimeve ishte më i madh se numri i vendeve bosh, komisionerët do të përzgjidheshin me short.

²³ Në këto KZAZ, një tjetër komisioner dhe një sekretar pa të drejtë vote u emëruan *ex officio* nga KQZ-ja.

²⁴ Në këto KZAZ, sekretarët pa të drejtë vote u emëruan *ex officio* nga KQZ-ja. Funksionet e kryetarëve u ushtruan nga zëvendëskryetarët.

²⁵ Dispozitat e ndryshme të Kodit Zgjedhor për përbërjen e administratës zgjedhore u referohen "partive politike që përfaqësojnë shumicën parlamentare dhe opozitën parlamentare", "partive politike të regjistruara" ose "subjekteve zgjedhore".

ku Grupet e Numërimit numërojnë votat në mënyrë të përqendruar. Për plotësimin e vendeve që mbetën bosh, KQZ-ja bëri një ftesë të hapur për aplikime dhe miratoi më pas një listë të kandidatëve të mundshëm si anëtarë të KQV-ve. KZAZ-të i formuan KQV-të pas afatit ligjor të 11 qershorit.²⁶ Më 25 qershor, pesë ditë pas afatit për formimin e tyre, KQZ-ja vendosi që Grupet e Numërimit të përbëheshin nga dy anëtarë të propozuar nga PS-ja dhe dy anëtarë të propozuar nga KZAZ-ja. Në ditën e zgjedhjeve, shumica e KQV-ve dhe Grupeve të Numërimit të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it përbëheshin nga katër anëtarë. Megjithatë, katër përqind e KQV-ve të vëzhguara funksionuan pa kuorumin e kërkuar. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it pretenduan se komisionerët e emëruar *ex officio* ishin pa përvojë ose përfaqësonin në të vërtetë PS-në.²⁷

Duhet të merren masa efikase për të forcuar më tej metodat e rekrutimit dhe trajnimit të komisionerëve, me qëllim për të garantuar profesionalizmin e tyre. Për rritjen e kapacitetit profesional të komisioneve zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të ofrojë trajnime periodike dhe certifikim të komisionerëve të mundshëm, me qëllim krijimin e një regjistri personash të kualifikuar.

VI. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Të drejtën për të votuar e gëzojnë shtetasit shqiptarë të moshës 18 vjeç ose më shumë në ditën e zgjedhjeve. Personave që janë duke vuajtur një dënim me burg për shkak të kryerjes së veprave të caktuara penale u mohohet e drejta për të votuar.²⁸ Kufizimet e të drejtës së votës për shtetasit e paaftë mendërisht, qoftë edhe në bazë të një vendimi gjykatë, janë në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare.²⁹ Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it dhe praktikave të mira ndërkombëtare, personat që nuk kanë shtetësi shqiptare nuk kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet vendore, pavarësisht kohës së tyre të qëndrimit në vend.³⁰ Zgjedhësit me moshë mbi 100 vjeç hiqen automatikisht nga lista e zgjedhësve dhe duhet të vërtetojnë të dhënat e tyre që të futen sërish në listë, pavarësisht një rekomandimi të hershëm të ODIHR-it.

Duhet të rishikohen kufizimet e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuar mendore dhe për personat që nuk kanë shtetësi shqiptare në zgjedhjet vendore.

Sistemi i regjistrimit të zgjedhësve është një sistem pasiv. Listat e zgjedhësve bazohen në Regjistrin Kombëtar elektronik të Gjendjes Civile (RKGjC), i cili mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e

²⁶ KQV-të përbëhen dhe emërohen duke përdorur një formulë të ngjashme me atë të përdorur për KZAZ-të. Ligji nuk parashikon shprehimisht se si plotësohen vendet bosh në KQV, por parashikon që KZAZ-të "të marrin masat e nevojshme" për t'u mundësuar KQV-ve arritjen e kuorunit të shumicës së thjeshtë prej katër anëtarësh.

²⁷ Një përfaqësues i PD-së e informoi MVZ-në e ODIHR-it se opozita i kishte dekurajuar mbështetësit e saj për të marrë pjesë në procesin e hapur të aplikimit të ndërmarrë nga KQZ-ja.

²⁸ Ligji i Dekriminalizimit ua pezullon të drejtën e votës shtetasve që janë duke vuajtur një dënim me burg për kryerjen e veprave penale të parashikuara në rreth 60 nene të Kodit Penal.

²⁹ Shih nenet 12 dhe 29 të Konventës së vitit 2006 për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDKPAK). Shih gjithashtu pikën 9.4 të Komunikatës 1 me Nr. 4/2011 të vitit 2013 të Komitetit të KDKPAK-së (*Zsolt Bujdosó e të tjerë kundër Hungarisë*), ku thuhet se: "Neni 29 nuk parashikon asnjë kufizim të arsyeshëm dhe as nuk lejon asnjë përjashtim për asnjë nga grupet e personave me aftësi të kufizuar. Për këtë arsye, përjashtimi nga e drejta për të votuar për shkak të një aftësie të kufizuar psikosociale apo intelektuale të mirëqenë apo të perceptuar, duke përfshirë edhe kufizimin sipas një vlerësimi të individualizuar, përbën diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar".

³⁰ Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut në [Komentin e Përgjithshëm 25](#) të vitit 1996 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike konfirmon ekzistencën e një tendence të re të dhënies së të drejtave për të votuar banorëve të përhershëm në zgjedhjet vendore. Kodi i Praktikave të Mira të Komisionit të Venecias në Çështjet Zgjedhore i vitit 2002 shpreh: "Do të ishte e rekomandueshme që të huajve t'u jepet mundësia për të votuar në zgjedhjet vendore pas një kohe të caktuar qëndrimi në vendin përkatës".

Gjendjes Civile (DPGjC) e Ministrisë së Brendshme dhe përfshin të gjithë zgjedhësit me vendbanim zyrtar në Shqipëri.³¹ Zgjedhësit ishin përfshirë në listat e zgjedhësve të qendrave të votimit që mbulojnë vendbanimin e tyre dhe këto ishin të vetmet qendra ku ata mund të votonin, pa patur mundësinë për të votuar me postë, me kuti të lëvizshme votimi, ose nga jashtë shtetit.³² Lista përfundimtare e zgjedhësve përmbante 3,536,016 zgjedhës, duke përfshirë edhe një numër të paspecifikuar zgjedhësish që jetojnë jashtë shtetit, por që vazhdojnë ta kenë vendbanimin zyrtar në Shqipëri.

DPGjC-ja raportoi se cilësia e listës së zgjedhësve ishte përmirësuar me heqjen e dublimeve dhe me uljen e numrit të zgjedhësve për të cilët nuk kishte një adresë të plotë nga 284,065 në dhjetor 2018 në 727 më 21 maj. Ndonëse kjo mund ta ketë rritur saktësinë e listës së zgjedhësve, disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë edhe një auditues të emëruar nga KQZ-ja për listat e zgjedhësve, u shprehën se për shkak të volumit të të dhënave, disa adresa mund të ishin ricaktuar pa u verifikuar.

Kodi Zgjedhor u ofron mekanizma të mjaftueshëm zgjedhësve për të kërkuar korrigjime të të dhënave të tyre. Pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, DPGjC-ja publikoi ekstrakte të përditësuara të listave të zgjedhësve çdo muaj, duke u dhënë mundësi zgjedhësve të regjistronin çfarëdolloj ndryshimi në zyrat vendore të gjendjes civile. Korrigjime të të dhënave të zgjedhësve mund të bëhen deri në 40 ditë para zgjedhjeve. Që nga ai moment dhe deri 24 orë para datës së zgjedhjeve, kërkesat për ndryshime apo përfshirje në lista të zgjedhësve mund të bëhen vetëm me vendim të gjykatës së rrethit përkatës gjyqësor. Ndonëse ligji parashikon që çdo zgjedhës të marrë një njoftim me shkrim nga autoritetet bashkiake mbi vendndodhjen e qendrës së tyre të votimit, MVZ-ja e ODIHR-it u informua se në disa bashki ky detyrim ishte neglizhuar.³³ Edhe të dhënat për kohën dhe vendin e votimit u bënë publike në listat e zgjedhësve të afishuara në KZAZ dhe KQV; megjithatë, në mesin e muajit qershor, listat e zgjedhësve u hoqën me urdhër të kryetarëve të bashkive të drejtuara nga opozita, duke i privuar zgjedhësit në këto bashki nga mundësia për të verifikuar të dhënat e tyre.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdo zgjedhës me të drejtë vote mund të kandidojë për zgjedhje në bashkinë ku ka vendbanimin, me përjashtim të atyre të cilëve u është kufizuar kjo e drejtë nga Ligji i Dekriminalizimit i vitit 2015.³⁴ Në Kushtetutë renditen, gjithashtu, disa kategori zyrtarësh funksionet e të cilëve janë të papajtueshme me të drejtën për të kandiduar.³⁵

Për të regjistruar kandidatët e tyre, partitë politike, koalicionet e partive dhe grupet e zgjedhësve duhet të regjistrohen fillimisht në KQZ si subjekte zgjedhore. Partitë dhe grupet e zgjedhësve duhet të paraqesin firma mbështetëse të jo më pak se një përqind të zgjedhësve të bashkisë përkatëse, në qoftë se ato nuk kanë qenë të përfaqësuara në Kuvend apo në qeverisjen vendore për një periudhë prej të paktën gjashtë muajsh.

³¹ Listat e zgjedhësve hartohen nga zyrat vendore të gjendjes civile, ku zgjedhësit përfshihen sipas vendbanimit të tyre.

³² Qendra të posaçme votimi, 19 gjithsej, u organizuan në spitale, burgje, dhe qendra paraburgimi.

³³ Në një sërë ZAZ-sh, zgjedhësit pretenduan se nuk i kishin marrë këto njoftime. Përveç kësaj, nënkryetari i Bashkisë Shkodër e informoi MVZ-në e ODIHR-it se ishte përgjegjësi e KZAZ-ve që të shpërndanin njoftimet për zgjedhësit, kurse në ZAZ-në Nr. 30 (Tiranë), njoftimet u shpërndanë me ndihmën e vullnetarëve të PS-së.

³⁴ Këtu përfshihen shtetasit e dënuar për krime të caktuara ose shtetasit e deportuar, madje edhe në mungesë të një vendimi të formës së prerë të gjykatës, nga shtetet anëtare të BE-së, Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara, si dhe ata ndaj të cilëve është lëshuar urdhër ndërkombëtar ndalimi.

³⁵ Këtu përfshihet Presidenti, zyrtarët e lartë shtetërorë, gjyqtarët, prokurorët, ushtarakët, punonjësit e policisë dhe të strukturave të sigurisë kombëtare, diplomatët dhe anëtarët e komisioneve zgjedhore.

KQZ-ja demonstroi qartazi një qasje gjithëpërfshirëse në regjistrimin e kandidatëve. Ndërkohë që kjo qasje rriti numrin e garuesve në fletët e votimit, KQZ-ja e interpretoi ligjin në një mënyrë tejet të gjerë dhe ndonjëherë jokonsistente, duke e ulur sigurinë juridike. KQZ-ja e regjistroi Partinë Bindja Demokratike (PBD) si subjekt zgjedhor më 27 prill, ndonëse kjo e fundit ishte regjistruar si parti politike vetëm më 25 prill me një vendim gjykate që mori formë të prerë më 10 maj.³⁶ KQZ-ja nuk i kërkoi partisë së saporegjistruar PBD të mblidhte firma mbështetëse.³⁷

Kodi Zgjedhor e ndalon bërjen e ndryshimeve në listat e kandidatëve pas miratimit të tyre përfundimtar dhe nuk e rregullon tërheqjen e kandidatëve. KQZ-ja hodhi poshtë disa kërkesa për tërheqje nga gara të paraqitura nga kandidatë për kryetarë bashkie të PBD-së, duke i lënë kështu emrat e tyre në fletën e votimit.³⁸

Rregullat për regjistrimin dhe tërheqjen e kandidatëve duhet të formulohen saktë dhe zbatimi i tyre nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të orientohet nga parimi i sigurisë juridike.

Ligji për Barazinë Gjinore parashikon një përfaqësim prej të paktën 30 përqind gra në të gjitha institucionet e sektorit publik në nivel kombëtar dhe lokal. Më 2015-ën, në Kodin Zgjedhor u fut kuota gjinore prej 50 përqind për listat e kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë, ku një në çdo dy kandidatë duhet t'i përkasë secilës gjini. Kjo krijoi një mjedis të favorshëm për një pjesëmarrje më të madhe politike të grave, të cilat fituan 706 mandate si anëtare të këshillave bashkiake (rreth 44 përqind) dhe 8 mandate si kryetare bashkie (13 përqind).

Mospërmbushja e kriterit të kuotës gjinore çoi në mospranimin e dy lista kandidatësh.³⁹ Shkaqet për mospranimin e listave apo kandidatëve të tjerë ishin mosdorëzimi i dokumentacionit brenda afateve dhe mospërmbushja e kriterit të vendbanimit. KQZ-ja i publikoi me vonesa të konsiderueshme vendimet për mosregjistrimin e kandidatëve dhe ato për regjistrimin e tyre pas pranimit të ankimeve, duke ndikuar kështu negativisht në transparencën e procesit të regjistrimit të kandidatëve.

Në total, për kryetarë bashkie kandiduan 97 kandidatë, duke përfshirë 11 gra dhe 6 kandidatë të pavarur. Koalicioni i drejtuar nga PS-ja "Aleanca për Shqipërinë Evropiane" doli me kandidatë në të gjitha 61 bashkitë, në 31 prej të cilave nuk pati kundërshtarë. Për këshillat bashkiakë garuan 2 koalicione, 38 parti politike, duke përfshirë 9 parti që garuan të vetme dhe 11 kandidatë të pavarur në 544 lista kandidatësh, në total 9,872 kandidatë, duke përfshirë 4,839 gra (ose 49 përqind). Megjithatë, heqja dorë e partive kryesore opozitare nga procesi zgjedhor ua kufizoi votuesve mundësinë e

³⁶ Më 2013-ën dhe 2015-ën, KQZ-ja refuzoi regjistrimin e Partisë Civile të Shqipërisë dhe Partisë Shkodra 2015 përkatë, të cilat nuk kishin paraqitur vendime të formës së prerë të gjykatës për regjistrimin e tyre si parti politike.

³⁷ Kodi Zgjedhor nuk specifikon se si duhet të llogaritet kjo periudhë gjashtë-mujore në Kuvend, në Këshillin Bashkiak apo në postin e Kryetarit të Bashkisë, gjë që lehtësoi anashkalimin e këtij kriteri nga KQZ-ja. Kjo e fundit e regjistroi PBD-në si parti parlamentare mbi bazën e vërtetimeve të lëshuara nga Kuvendi, në të cilat periudha gjashtë-mujore llogaritej duke u nisur nga data e përfundimit të parashikuar të mandatit të dy deputetëve të lidhur me PBD-në në vitin 2021. GjEDNj-ka kërkon që kushtet për pjesëmarrjen në zgjedhje "të jenë në përputhje me një sërë kriteresh të vendosura për të parandaluar vendimet arbitrare. [...] diskrecioni që gëzon organi në fjalë nuk duhet të jetë jashtëzakonisht i gjerë; ai duhet përshkruar me saktësi të mjaftueshme në dispozitat e legjislacionit vendas". Shih çështjen [Podkolzina kundër Letonisë](#) (aplikimi nr. 46726/99, 6 korrik 2002), paragrafi 35.

³⁸ Përfaqësues të PBD-së e informuan MVZ-në e ODIHR-it se disa prej kandidatëve të tyre u tërhoqën për shkak të presionit nga PD-ja (në Kamëz, Kavajë dhe Lezhë), kurse njëri për shkak të presionit nga PS-ja (në Skrapar). Përveç kësaj, një nga kandidatët pretendoi se i ishte falsifikuar firma në dokumentet e regjistrimit.

³⁹ Më 22 maj, KQZ-ja nuk i pranoi listat e kandidatëve për Lezhën dhe Vlorën, paraqitur nga Partia Aleanca Demokristiane, anëtare e koalicionit të drejtuar nga PS-ja. Më 30 maj, në të vetmin rast që lidhej me zbatimin e kuotës gjinore, Kolegji Zgjedhor e la në fuqi vendimin e KQZ-së për të mos e pranuar listën.

zgjedhjes mes alternativave të ndryshme politike. Që të gjithë 26 kryetarët e bashkive nga partitë opozitare, të cilëve u mbaronte mandati, zgjedhën të mos rikandidojnë.

VIII. MJEDISI I FUSHATËS

Fushata, e cila filloi më 31 maj dhe zgjati deri në fillimin e heshtjes zgjedhore më 29 qershor, ishte kryesisht e padukshme.⁴⁰ Përveç stendave të afishimit të materialeve për edukimin e zgjedhësve, të cilat iu dhanë autoriteteve bashkiake nga KQZ-ja, MVZ-ja e ODIHR-it evidentoi një numër të vogël posterash ose shenjash të tjera që tregonin për zgjedhje të afërta.⁴¹ Kandidatët e bënë fushatën kryesisht në mediat sociale, përmes vizitave derë-më-derë dhe takimeve të vogla me zgjedhësit. Debatet ballë-për-ballë mes kandidatëve ishin të pakta.⁴² Tubimet e vetme të mëdha për fushatë qenë ato ku Kryeministri ishte folësi kryesor, duke bërë fushatë për kandidatët e koalicionit të udhëhequr nga PS-ja, si në bashkitë e drejtuara nga PS-ja ashtu edhe në ato të drejtuara nga opozita.⁴³

Aktivitetet e kufizuara të fushatës mbetën në hije për shkak të zhvillimeve në shkallë vendi që i thelluan edhe më tej ndarjet e hershme politike. Diskutimi politik u fokusua te mospjesëmarrjen në zgjedhje të partive kryesore opozitare dhe te data e zgjedhjeve. Qytetarët u ekspozuan ndaj pikëpamjeve të ndryshme rreth vetë zgjedhjeve, të cilat në shumë zona ishin jokonkurruese, përmes medias audiovizive, medias së shkruar dhe asaj sociale, tubimeve publike dhe takimeve me përfaqësues të partive politike. Me afrimin e ditës së zgjedhjeve, drejtuesit e opozitës dhe Presidenti bënë deklarata gjithmonë e më kritike, ku theksohej mungesa e konkurrencës si një tregues i synimit të supozuar të PS-së për vendosjen e regjimit njëpartiak. Kryeministri ritheksoi se partitë opozitare, që kishin kryetarë bashkie dhe shumicën në këshillat vendorë të shumë bashkive, ishin vetëpërrjashtuar nga zgjedhjet. Gjuha me të cilën kundërshtarët politikë iu drejtuan njëri-tjetrit ishte shpesh e nderur dhe e mbushur me akuza dhe kundërakuzat.⁴⁴

Shumë kandidatë i shprehën MVZ-së së ODIHR-it vështirësitë në motivimin e zgjedhësve për të marrë pjesë në votim. Shumica e përfaqësuesve të partive përshkruan zhgënjimin e tyre nga situata e

⁴⁰ Garuesit e respektuan periudhën e heshtjes zgjedhore. Gjatë këtyre ditëve, PD-ja, e cila nuk garonte, u bëri thirrje në mënyrë të përsëritur qytetarëve të bojkotonin votimin dhe të regjistronin dhe të filmonin çdo abuzim në ditën e zgjedhjeve. LSI-ja bëri deklarata përmes të cilave sulmoi Kryeministrin dhe drejtuesen e grupit parlamentar demokrat, Rudina Hajdari, e cila është zgjedhur në vitin 2017 nga lista e kandidatëve për deputetë e PD-së dhe nuk e dorëzoi mandatin në shkurt të 2019-ës. PD-ja dhe LSI-ja u bënë thirrje qytetarëve që të mos ushtronin dhunë e të mos provokonin në ditën e zgjedhjeve.

⁴¹ Materialet për edukimin e zgjedhësve përmbanin oraret e votimit, por jo datën e zgjedhjeve. MVZ-ja e ODIHR-it evidentoi materiale vizuale të afishuara në zyrat rajonale të PS-së dhe jashtë tyre. PBD-ja shpërndau fletëpalosje dhe hapi zyra zgjedhore në disa qytete, duke afishuar materiale të fushatës në pjesën e jashtme të tyre në vende të ndryshme. Disa kandidatë të PS-së hapën zyra të përkohshme, sidomos në Tiranë dhe rreth saj.

⁴² Përrjashtim bëri Durrësi, ku më 22 qershor, në një debat të organizuar nga OJQ-të lokale, të dyja kandidatet gra për kryetar bashkie (PS dhe PBD) diskutuan çështje të zhvillimit të komunitetit para një audience prej 200 vetësh. Menjëherë pas debatit, kandidatja e PS-së shpërndau një fletëpalosje ku përshkruante platformën e saj të fokusuar në çështjet lokale; ishte e vetmja fletëpalosje prej të gjithë kandidatëve të PS-së që u konstatua në terren nga MVZ-ja e ODIHR-it.

⁴³ Më 13 qershor, mitingu i PS-së në Librazhd u ndërpre nga disa qindra protestues që hidhnin vezë dhe mjete piroteknike, të cilat çuan në arrestimin dhe nisjen e ndjekjes penale kundër disa zyrtarëve dhe mbështetësve të PD-së. Megjithatë, më 20 qershor, kryetarja e bashkisë së Shkodrës tentoi të parandalonte një miting të PS-së, duke drejtuar një protestë në të njëjtën kohë me të, e cila përfundoi me hedhjen e mjeteve zjarrvënëse në drejtim të një kordonit të ngjeshur policie që qëndronte mes dy tubimeve. Policia përdori gaz lotsjellës për të shpërndarë protestuesit.

⁴⁴ Për shembull, duke folur me median gjatë një proteste të udhëhequr nga PD-ja më 2 qershor, ish-Presidenti dhe ish-Kryeministri Sali Berisha e përshkroi Kryeministrin si një “kufomë politike të pakallur”. Politikanët iu referuan zakonisht njëri-tjetrit duke përdorur nofka, të cilat ishin shpesh përbuzëse. Kryeministri i referohej shpesh drejtuesit të PD-së si “Pinoku”, kurse drejtueses së LSI-së si “fallxhorja”.

përgjithshme e jetës politike dhe ndikimin që ajo kishte në komunitetet e tyre lokale. Bashkëbisedues të ndryshëm nga i gjithë spektri politik ndanë me MVZ-në e ODIHR-it besimin e tyre se nevojitej një marrëveshje mes partive për të mos lejuar gërryerjen e mëtejshme të besimit të demokracia, zgjedhjet dhe politikanët. Disa u shprehën mosbesues ndaj strategjive të ndjekura nga drejtuesit e partive të tyre.⁴⁵ Të tjerë folën për mungesën e dialogut të brendshëm në parti që i kishte bërë ata të largoheshin nga partitë e tyre dhe të kandidonin në emër të partive të tjera ose si të pavarur. Disa zyrtarë partish, duke përfshirë edhe disa drejtues partish, theksuan nevojën për më shumë demokraci të brendshme të partive.⁴⁶

Për parandalimin e toneve të nxehta dhe gjuhës fyese gjatë fushatës, partitë politike dhe subjektet garuese zgjedhore mund të hartojnë dhe t'i përmbahen një kodi të përbashkët etike. Partitë politike duhet të forcojnë zbatimin e kodeve të tyre të brendshme etike, të nxisin demokracinë e brendshme partiake dhe të garantojnë respektimin dhe promovimin e transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit nga strukturat e tyre të brendshme.

Qytetarët, sidomos ata që punonin në administratën publike, u përballën me presione për të shfaqur preferencat e tyre politike, gjë që bie ndesh me paragrafin 7.7 të Dokumentit të vitit 1990 të Kopenhagenit të OSBE-ë.⁴⁷ MVZ-së së ODIHR-it iu shprehën shqetësime nga qytetarë se pjesëmarrja apo mospjesëmarrja në votim mund t'i ekspozonte ata ndaj pasojave në komunitetet e tyre. Disa prej tyre përshkruan frikësimin e drejtpërdrejtë dhe kërcënimet për pushim nga puna ose për heqje të përfitimeve nga shërbimet sociale.⁴⁸

Në MVZ-në e ODIHR-it u paraqitën pretendime të shumta sipas të cilave, pavarësisht ndalimeve ekzistuese në kuadrin ligjor dhe masave të reja të miratuara në muajin maj, punonjësit e administratës publike dhe të ndërmarrjeve të shërbimeve me pronësi shtetërore u ndodhën përballë presionesh direkte dhe indirekte për t'u angazhuar në aktivitete politike gjatë dhe pas orarit të punës.⁴⁹ Kryetarja e bashkisë së Shkodrës (PD) i urdhëroi të gjithë punonjësit e administratës bashkiake të punonin nga ora 07:00 deri në orën 19:00 si më 29 ashtu edhe më 30 qershor.⁵⁰ MVZ-ja e ODIHR-it pa zyrtarë bashkiakë dhe punonjës të shërbimeve shëndetësore dhe arsimore në mitingjet e mëdha të PS-së, të cilat në shumë qytete u mbajtën fill pas orarit të punës. MVZ-ja e ODIHR-it vuri re gjithashtu edhe perceptime të gjera mes bashkëbiseduesve dhe publikut se punësimi në sektorin publik varet nga

⁴⁵ Një bashkëbisedues i MVZ-së së ODIHR-it tha se strategjia “ishte imponuar nga aktorët më të mëdhenj partiakë”. Një kryetar bashkie i opozitës u shpreh kritik ndaj mungesës së vullnetit të drejtuesve të partive për të arritur një zgjidhje politike. Një tjetër kryetar bashkie i opozitës iu shpreh MVZ-së së ODIHR-it se ai nuk kishte një qëndrim të prerë në lidhje me bojkotin, por i përmbahej linjës partiake për zbatimin e tij. Dy kandidatë për kryetarë bashkie të PS-së u shprehën se shpresonin që zgjedhjet të shtyeshin.

⁴⁶ Një kandidat i PS-së e informoi MVZ-në e ODIHR-it se “konfliktet më të mëdha politike në Shqipëri janë brendapërbrenda partive”. Paragrafët 61 dhe 110 të [Udhëzimeve të vitit 2010 të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për Rregullimin e Partive Politike](#) i referohen praktikës së mirë të gjithëpranuar se funksionet e brendshme të partive politike respektojnë parimet e mosdiskriminimit dhe barazisë dhe se “statutet e partive duhet të miratohen përmes një procesi me pjesëmarrje ... dhe jo nga kryetari i partisë si individ, si dhe u duhen vënë në dispozicion masivisht anëtarësisë së partisë”.

⁴⁷ Paragrafi 7.7 i [Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 të OSBE-së](#) kërkon që Shtetet pjesëmarrëse “të marrin masat që ligji dhe politikat publike të funksionojnë në mënyrë të tillë që të lejojnë zhvillimin e fushatave politike në një atmosferë të lirë dhe të ndershme, ku as masat administrative dhe as dhuna apo frikësimi të mos mund t'i pengojnë partitë dhe kandidatët që të prezantojnë lirisht pikëpamjet dhe cilësitë e tyre dhe as të pengojnë zgjedhësit që t'i njohin dhe t'i diskutojnë ato apo që ta hedhin votën pa pasur frikë nga ndëshkimi”.

⁴⁸ Për shembull, në Devoll, dy punonjës të bashkisë i treguan MVZ-së së ODIHR-it kopje të letrave të dërguara nga kryetari i bashkisë më 1 korrik, përmes të cilave i pushonte nga puna, vendim që hynte në fuqi në të njëjtën ditë. Që të dy pretenduan se ishin pushuar për shkak të mosmbështetjes së bojkotimit të zgjedhjeve. Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil nisi një hetim për njërin prej këtyre pushimeve.

⁴⁹ Me fillimin e fushatës, Komisioni për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil nxori udhëzime për neutralitet, paanshmëri dhe integritet në kryerjen e detyrës gjatë periudhës zgjedhore.

⁵⁰ Kryetarja e bashkisë e bëri urdhrin të ditur në një [konferencë për shtyp më 26 qershor](#).

përkatësia politike.⁵¹ Të gjitha bashkë, këto bien ndesh me paragrafin 5.4 të Dokumentit të vitit 1990 të Kopenhagenit të OSBE-së.⁵²

Autoritetet dhe partitë politike duhet të ndërmarrin masa maksimale për eliminimin e problemit të hershëm të shpërdorimit të burimeve administrative në zgjedhje dhe në periudhat midis zgjedhjeve. Autoritetet duhet të nxjerrin rregulla të sakta që përcaktojnë se si mund dhe nuk mund të përdoren burimet publike për qëllime zgjedhore. Hapa të mëtejshëm duhet të merren për arritjen e depolitizimit të shërbimit civil dhe për të garantuar mosushtrimin e presionit ndaj zgjedhësve me qëllim pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të fushatave zgjedhore apo votimin në një mënyrë të caktuar.

Punonjësit e bashkisë ishin mes atyre protestuesve që MVZ-ja e ODIHR-it i pa teksta e penguan fizikisht administratën zgjedhore në të paktën 13 bashki të drejtuara nga kryetarë që i përkisnin opozitës.⁵³ Pjesa më e madhe e këtyre rasteve përfshiu shkatërrimin e materialeve zgjedhore, si dhe përplasjet mes Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit.⁵⁴ Më 28 dhe 29 qershor, zjarret e vëna nga protestuesit shkatërruan ambientet e administratës zgjedhore në Bushat, Has dhe Vau i Dejës.⁵⁵

Pavarësisht një numri të konsiderueshëm kandidatësh gra, gratë vazhdojnë të mbajnë pak pozicione drejtuese në partitë politike.⁵⁶ Me përjashtim të një numri të vogël, gratë politike nuk spikatën, por morën pjesë në fushatë dhe në protestat e opozitës.⁵⁷

Gratë politike afër opozitës ishin të parat që bënë thirrje për t'i dhënë fund dhunës dhe vandalizmit që shoqëronte protestat, duke përfshirë ato në Shkodër. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it vunë në dukje se kërcënimet për dhunë mund të kenë penguar pjesëmarrjen e grave në tubimet publike dhe si zgjedhëse dhe vëzhguese zgjedhjesh. Disa gra politike i përshkruan MVZ-së së ODIHR-it

⁵¹ Kur ndërrohet qeverisja vendore, administratat e reja zakonisht e rristrukturojnë personelin, duke çuar në një qarkullim të madh të punonjësve. Gjatë mitingjeve të PS-së në Elbasan (ku kryetari i bashkisë ishte i PS-së) dhe në Skrapar (ku kryetari ishte i LSI-së), në të cilat kandidatët për kryetar bashkie të koalicionit të drejtuar nga PS-ja kandidonin pa kundërshtarë, Kryeministri (njëherësh edhe kryetari i PS-së) premtoi se gratë dhe ata që nuk ishin përdorur si “mish për top” të partive politike nuk do ta humbisnin vendin e punës në administratën e re të bashkisë. Kryeministri e përsëriti këtë premtim në [deklaratat e tij pas zgjedhjeve](#).

⁵² Paragrafi 5.4 i Dokumentit të vitit 1990 i Kopenhagenit të OSBE-së kërkon që Shtetet pjesëmarrëse të ruajnë “një ndarje të qartë midis shtetit dhe partive politike; partitë, veçanërisht, nuk duhet të shkrimen me shtetin”.

⁵³ Incidente ndodhën në Devoll, Dibër, Has, Kamëz, Kavajë, Kukës, Mat, Pogradec, Përrenjas, Shkodër, Tropojë, Vau i Dejës dhe Vorë. Mes të tjerash, iu vu zjarri një shkollë në Shkodër; u hodhën koktejlje Molotov drejt policisë në Kavajë; protestuesit shkelluan derën e muzeut të qytetit dhe hodhën brenda bomba tymuese në Tropojë. Në Dibër, policia përdori gazin lotsjellës për të shpërndarë protestuesit që po hidhnin mjete piroteknike drejt punonjësve të policisë.

⁵⁴ Ministri i Brendshëm [njoftoi](#) se, duke pasur parasysh përdorimin e policisë bashkiake në disa bashki për të minuar zgjedhjet, ai do ta riorganizonte këtë polici. Komisioni për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i udhëzoi ekipet e tij monitoruese të merrnin masa disiplinore ndaj nëpunësve civilë të përfshirë në akte të dhunshme kundër administratës zgjedhore. Shkalla e respektimit të këtij udhëzimi varioi ndjeshëm nga një bashki në tjetrën, nga pretendimet nga bashkitë Berat, Kavajë, Kukës, Lezhë, Mallakastër, Mat, Përrenjas, Shkodër dhe Tropojë për pavlefshmëri të këtij udhëzimi për shkak të dekretit të 10 qershorit të Presidentit, deri te fillimi i procedurave disiplinore kundër punonjësve që i kishin shprehur publikisht preferencat e tyre politike.

⁵⁵ Duke iu referuar Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore, më 28 qershor, Kryeministri [shkarkoi](#) kryetarin e bashkisë së Vaut të Dejës për shkelje të rënda të autoritetit kushtetues.

⁵⁶ Komiteti i CEDAW, në [Vëzhgimet e tij Përmblyëse në raportin e katërt periodik](#) të Shqipërisë (25 korrik 2016, CEDAW/C/ALB/CO/4, paragrafi 26) theksoi rritjen e përfaqësimit të grave në jetën politike, por tërhoqi vëmendjen ndaj përfaqësimit të tyre të pamjaftueshëm në role vendimmarrëse dhe ndaj pengesave për pjesëmarrje që vazhdojnë të hasin grupet e disavantazuara dhe të marxhinalizuara, si për shembull gratë rome dhe ato egjiptiane, si dhe gratë me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe ushtrimin e së drejtës së tyre për të votuar.

⁵⁷ Dy parti politike, LSI-ja dhe Partia Aleanca Kuq e Zi, drejtohen nga gra. Shih [Vendimin Nr. 7/09 të Këshillit Ministror të OSBE-së](#) për Pjesëmarrjen e Grave në Jetën Politike dhe Publike, i cili u kërkon Shteteve Pjesëmarrëse “Të inkurajojnë të gjithë aktorët politikë që të promovojnë pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në partitë politike me qëllim arritjen e një përfaqësimi më të mirë sa i përket ekuilibrit gjinor në postet e zgjedhura publike në të gjitha nivelet e vendimmarrjes”.

vështirësitë e veçanta në promovimin e pjesëmarrjes së grave si kandidatë, anëtare të komisioneve zgjedhore dhe zgjedhëse në zonat rurale, ku mundësitë e pamjaftueshme për shkollim dhe normat tradicionale konservatore çojnë që të gjitha në mundësi të kufizuara.

Duhet të ketë më shumë ndërgjegjësim për rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në jetën publike dhe politike, si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale, duke i mëshuar në mënyrë të veçantë rolit të grave brenda partive politike dhe në proceset zgjedhore.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Fushatat zgjedhore mund të financohen nga fonde publike dhe private, duke përfshirë edhe kreditë. Fondet publike u jepen partive për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të zakonshme, bazuar në rezultatet e tyre në zgjedhjet e fundit për Kuvendin. Për qëllime fushate, të gjitha partive që marrin pjesë në zgjedhje u jepen fonde publike shtesë si paradhënie, që rillogariten pas zgjedhjeve.⁵⁸ Më 16 maj, Kuvendi miratoi një shumë prej 65 milion lekësh (rreth 533,000 Euro) për këto qëllime.⁵⁹ Më 10 qershor, KQZ-ja e ndau këtë shumë mes subjekteve garuese në raport me rezultatet e tyre në zgjedhjet e mëparshme vendore: 41 milion lekë i shkuan PS-së, kurse pjesa tjetër 35 partive të tjera garuese. Partitë që sigurojnë më pak vota sesa do të duhet të merrnin për të pasur të drejtën e përfitimit të fondeve të dhëna, duhet të kthejnë diferencën. Kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtë të përfitojnë fonde publike.

Dhurimet si nga qytetarët ashtu edhe nga subjektet juridike vendase, duke përfshirë edhe dhurimet në natyrë, kanë një kufi prej 1 milion lekësh (rreth 8,200 Euro).⁶⁰ Kontributet që e tejkalojnë shumën prej 100,000 lekësh duhet të bëhen përmes një llogarie bankare të hapur posaçërisht për këtë qëllim. Çdo subjekt zgjedhor duhet t'i regjistronte të gjitha dhurimet në një regjister të posaçëm të miratuar si formular model nga KQZ-ja. Shpenzimet për fushatë gjithsej për këto zgjedhje nuk mund të tejkalonin shumën ekuivalente prej përkatësisht 408 milion lekësh për partitë politike dhe 20.4 milion lekësh për kandidatët e pavarur. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it pretenduan se meqenëse opozita nuk mori pjesë në zgjedhje, nuk ishte e nevojshme të shpenzohej shumë për fushatë dhe se shpenzimet në total ishin shumë të ulëta.

Në maj të vitit 2017, Ligji për Partitë Politike u ndryshua me qëllim uljen e kostove të fushatës, rritjen e transparencës së financimit të fushatave dhe llogaridhënies, si dhe për të futur masa të reja kundër shkeljeve në lidhje me zgjedhjet. Pak kohë para zgjedhjeve, KQZ-ja, e cila është organi mbikqyrës për çështje të financimit të fushatave, ofroi udhëzime të hollësishme për zbatimin e rregullave të financimit të fushatës nga garuesit dhe nga audituesit, duke kontribuar kështu në sigurinë juridike.

Më 11 prill, KQZ-ja nxori një udhëzim për verifikimin e shpenzimeve të fushatës, në bazë të të cilit emëroi më pas ekspertë financiarë për monitorimin e fushatave. Ajo çka ishte pozitive ishte se ekspertët nxorën raporte të përjavshme mbi shpenzimet për fushatë. Ndonëse këto raporte u publikuan në faqen zyrtare të KQZ-së, metodologjia e përdorur për hartimin e tyre nuk u zbatua gjithmonë njësoj. Në disa raporte përshkruheshin vështirësitë që kishin hasur ekspertët financiarë për gjetjen e zyrave të disa partive, gjë që pengoi monitorimin efikas. Disa ekspertë dukeshin se mbështeteshin

⁵⁸ Partitë që kanë marrë më shumë se 0.5 për qind të votave të vlefshme gjatë zgjedhjeve të fundit për Kuvendin marrin 95 për qind të fondeve, në raport të drejtë me numrin e votave të vlefshme të marra. Pjesa e mbetur prej 5 për qind u shpërndahet partive që kanë marrë më pak se 0.5 për qind të votave dhe partive që nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit.

⁵⁹ 1 Euro është e barabartë me afërsisht 122 lekë.

⁶⁰ Ndalohen kontributet anonime, dhurimet nga marrësit e fondeve dhe kontratave publike mbi një shumë të caktuar, dhurimet nga partnerët në projekte publike, kompanitë mediatike dhe debitorët e buxhetit të shtetit apo institucioneve shtetërore.

shumë tek informacionet që partitë politike ishin të gatshme t'u ofronin në vend që të bazoheshin tek analizimi që vetë ata mund t'u bënin të dhënave.

Në një tjetër hap pozitiv, KQZ-ja miratoi më 8 maj një formular të standardizuar dhe disa udhëzime për raportimin mbi financimin e fushatës, i cili iu kërkua të përdorej partive politike dhe, për herë të parë, edhe kandidatëve për kryetarë bashkie, për regjistrimin, dokumentimin dhe raportimin në lidhje me fondet e tyre të fushatës. KQZ-ja organizoi edhe një sërë seminaresh trajnimi për kandidatët për kryetarë bashkie dhe për partitë politike për mënyrën e dokumentimit të fondeve të marra dhe të shpenzuara gjatë fushatës.

Subjektet zgjedhore janë të detyruara të publikojnë dhe të paraqesin në KQZ raportet përfundimtare për të ardhurat dhe shpenzimet e tyre për fushatë brenda 60 ditësh nga shpallja e rezultateve zyrtare. Brenda pesë ditësh nga kjo shpallje, KQZ-ja duhet të caktojë audituesit që do të shqyrtojnë raportet përfundimtare të garuesve për financimin e fushatës. Ligji nuk parashikon ndonjë afat specifik për përfundimin e auditimit, por i kërkon KQZ-së t'i publikojë raportet e audituesve jo më vonë se 30 ditë pas paraqitjes së tyre.

KQZ-ja mund të vendosë gjoha ndaj garuesve dhe donatorëve për mosrespektim të rregullave për financimin e fushatës, si dhe për mosbashkëpunim me audituesit e KQZ-së. Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, gama e gjobave të aplikuara për shkelje të rregullave të financimit të fushatës nuk është dekurajuese, ndonëse shkelje të caktuara mund të çojnë deri në pesë vjet pezullim të financimit të një partie politike nga buxheti i shtetit. Në prill të vitit 2019, KQZ-ja e pohoi publikisht mungesën e dispozitave ligjore që do t'i jepnin mundësi KQZ-së të kryente hetime të thelluara financiare, veçanërisht hetime me nismën e saj apo hetime të transaksioneve jashtë shtetit.⁶¹ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën pikëpyetje në lidhje me efikasitetin në tërësi të mekanizmave të mbikëqyrjes së financimit të partive, duke argumentuar se ka mënyra përmes të cilave rregullat mund të anashkalohen dhe se audituesit mund të hezitojnë t'i mbikqyrin me hollësi financat e partive nga frika e pasojave.

Duhet të shihet mundësia e rishikimit të ligjit për të garantuar që KQZ-ja i ka kompetencat dhe procedurat e duhura për të mbikëqyrur dhe për të siguruar zbatimin në mënyrë efikase të rregullave të financimit të partive dhe fushatave.

X. MEDIA

A. MJEDISI I MEDIAS

Mjedisi mediatik është i larmishëm, por i kufizuar nga një treg i kufizuar reklamash. Sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, shkalla e kufizuar e fitimit të mediave ka bërë që ato të veprojnë si platforma lobuese për pronarët e tyre. Në mungesë të një vetërregullimi efikas dhe për shkak të pasigurisë për punën, gazetarët mbeten të prekshëm nga presioni dhe shpesh u duhet të përdorin autocensurën. Frikësimi, ngacmimet dhe sulmet ndaj gazetarëve, ndonëse dënohen nga autoritetet, rrallë hetohen plotësisht apo ndiqen penalisht, duke krijuar një atmosferë pandëshkueshmërie. Televizioni (TV) mbetet burimi kryesor i informacionit politik, ndërkohë që portalet *online* dhe mediat sociale kanë zëvendësuar me shpejtësi median e shkruar si burim i opinionit dhe komenteve politike. Ndryshimet e vitit 2016 në Ligjin për Mediat Audiovizive, ndonëse parashikojnë transparencë formale ndaj pronësisë së mediave, hoqën edhe kufijtë e shkallës së pronësisë së mediave audiovizive që mund të ketë një pronar i

⁶¹ Më 3 prill, Kryetari i KQZ-së prezantoi në Kuvend [raportin](#) për aktivitetet e KQZ-së për vitin 2018.

vetëm.⁶² Procesi i mëvonshëm i dixhitalizimit çoi në kontrollimin e tre prej pesë frekuencave kombëtare televizive nga një familje, duke sjellë shqetësime për përqendrimin e pronësisë.⁶³

Ligji për median audiovizive duhet të ndryshohet për të kufizuar në mënyrë efektive përqendrimin e pronësisë së medias në sektorin e transmetimit.

Pas dixhitalizimit, transmetuesi publik RTSH e ka zgjeruar ndjeshëm portofolin e tij, duke transmetuar tashmë në 12 kanale, përfshirë edhe RTSH-2 i cili transmeton në kohën me shikueshmërinë më të lartë në pesë gjuhë të pakicave kombëtare: arumune, greke, maqedonase, rome dhe serbe. RTSH-ja mbikqyret nga Këshilli Drejtues, një organ kolegjal prej 11 anëtarësh të zgjedhur nga Kuvendi.⁶⁴ Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, Thoma Gëllçi, ka qenë kryeredaktor i gazetës së PS-së *Zëri i Popullit* dhe ka shërbyer si Drejtues i Departamentit të Informacionit në disa qeveri të PS-së. Përveç kësaj, RTSH-ja mbetet pjesërisht e varur nga buxheti i shtetit.⁶⁵ Varësia nga buxheti i shtetit dhe politizimi i menaxhimit të RTSH-së ngrenë shqetësime rreth paanshmërisë së transmetuesit publik.⁶⁶

Autoriteti i Medias Audiovizuale (AMA) është rregullatori kryesor për mediat audiovizive. Ajo jep licencat transmetuese dhe mbikqyr respektimin e kuadrit ligjor nga media jashtë zgjedhjeve. AMA përbëhet nga një kryetar dhe gjashtë anëtarë, që të gjithë të zgjedhur nga Kuvendi. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime rreth paanshmërisë së këtij organi, sidomos gjatë dhënies së licencave transmetuese.⁶⁷ Më 4 korrik, Kuvendi shkarkoi një anëtar të AMA-s, duke dhënë si arsye konfliktin e interesit.⁶⁸

Pavarësia e rregullatorit të medias dhe transmetuesit publik duhet të forcohet më tej përmes masave që parandalojnë konfliktin e interesit. Pozicionet e nivelit të lartë drejtues në transmetuesin publik nuk duhet të jenë të aksesueshme për persona me lidhje të qarta politike.

B. KUADRI LIGJOR

Kushtetuta dhe legjislacioni parashikojnë lirinë e shprehjes dhe ndalojnë censurimin. Në kundërshtim me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, shpifja mbetet vepër penale, e dënueshme me gjobë deri

⁶² Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias (RFOM) [doli në përfundimin](#) se këto ndryshime “mundet që në planin afatgjatë të kenë ndikim shumë negativ në pluralizmin mediatik dhe, rrjedhimisht, në lirinë e medias në Shqipëri”. [Deklarata](#) e vitit 2009 e Raportuesit të Posaçëm të OKB-së për Lirinë e Opinionit dhe Shprehjes (RFOE) dhe e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias u bëri thirrje shteteve që “të merrnin një sërë masash, duke përfshirë [...] rregulla për të mos lejuar përqendrimin e tepruar të pronësisë së medias”.

⁶³ Sipas [Qendrës Kombëtare të Biznesit](#), familja Hoxha zotëron 100 për qind të *Top Channel* dhe rreth 51 për qind të *DigitAlb*. Ky i fundit zotëron 100 për qind të *ADTN*-së. Secila kompani zotëron një licencë kombëtare. Neni 62.4 i Ligjit për Mediat Audiovizive i ndalon çdo personi fizik ose juridik që zotëron një licencë kombëtare zotërimin e më shumë se 20 për qind të një kompanie që zotëron një tjetër licencë kombëtare.

⁶⁴ Gjashtë anëtarë janë propozuar nga partia qeverisëse dhe pesë nga opozita.

⁶⁵ Sipas RTSH-së, gjatë vitit 2018, rreth 30 për qind e [buxhetit](#) të saj vinte nga shteti, kurse 53 për qind nga taksa e transmetimit (100 lekë në muaj për familje). Rreth 9 për qind vinin nga reklamat, kurse pjesa tjetër nga dhënia me qira e antenave transmetuese ose nga transmetimet për palët e treta.

⁶⁶ Paragrafi 8.20 i [Rezolutës Nr. 1636 të vitit 2008 të PACE-s](#) “Treguesit e Medias në Demokraci” përcakton parimin tjetër bazë: “transmetuesit publikë duhet të mbrohen nga ndërhyrjet politike në menaxhimin e tyre të përditshëm dhe në punën e tyre editoriale. Pozicionet e karta drejtuese duhet t’u refuzohen personave me përkatësi të qarta politike”.

⁶⁷ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën pretendime se punësimi i mëparshëm i kryetarit të AMA-s si Drejtor i *DigitAlb*-it mund të ketë ndikuar në vendimin e këtij autoriteti për t’u dhënë disa licenca kombëtare kompanive të lidhura me pronarët e *DigitAlb*-it.

⁶⁸ Një raport i përbashkët i vitit 2001 i Përfaqësuesit të OKB-së për Lirinë e Opinionit dhe Shprehjes dhe Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias [thekson](#) se “rregullatorët e transmetimit dhe organet qeverisëse duhet të kenë përbërje të tillë që t’i mbrojnë ata nga ndërhyrjet politike apo komerciale”.

në 3 milionë lekë. Për më tepër, ndryshimet e propozuara në Ligjin për Mediat Audiovizive dhe në Ligjin për Komunikimet Elektronike, të miratuara nga qeveria dhe të vëna në dispozicion të publikut për shqyrtim më 3 korrik, i japin të drejtë rregullatorit që të heqë ose të ndryshojë përmbajtjen e faqeve të internetit dhe blogjeve për një gamë të gjerë shkeljesh, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me standardet profesionale dhe etike. Këto ndryshime parashikojnë gjithashtu edhe gjoba deri në 1 milionë lekë, të cilat duhet të paguhet para se të shterohen zgjidhjet ligjore. Këto ndryshime u kritikuan gjerësisht si në vend, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, përfshirë edhe nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, i cili theksoi se AMA “nuk duhet të jetë zëvendësuese e gjyqësorit të pavarur apo e mekanizmave të duhur vetërregullues sa u përket çështjeve të lirisë së shprehjes”.⁶⁹ Ndërkohë që këto ndryshime janë në proces votimi në Kuvend, miratimi i tyre në variantin aktual do të kishte një efekt dekurajues për median.

Mbulimi i fushatës në median audiovizive rregullohet hollësisht në Kodin Zgjedhor, ndërsa media e shtypur dhe ajo *online* janë në një masë të madhe të parregulluara. Ligji u ofron minutazh transmetimi falas në RTSH "partive të regjistruara", duke u akorduar ndjeshëm më shumë kohë atyre partive që kanë fituar mandate në zgjedhjet e fundit për Kuvendin sesa partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur që marrin pjesë në zgjedhjet e rradhës. KQZ-ja i interpretoi kriteret ligjore në mënyrë të tillë që i përjashtonte nga ndarja e kohës partitë politike parlamentare që nuk morën pjesë në këto zgjedhje.⁷⁰ Garuesit nuk shfaqën ndonjë interes të madh për minutazhin e transmetimit falas. Monitorimi i medias nga ana e MVZ-së së ODIHR-it tregoi se nga 102 hapësira falas që u ishin caktuar garuesve në RTSH-1, u përdorën vetëm 37 prej tyre.

Transmetuesit që transmetojnë reklama me pagesë të fushatës duhet t'u ofrojnë garuesve të njëjtat çmime dhe t'ia dërgojnë listën e çmimeve KQZ-së.⁷¹ Vetëm 7 nga 54 transmetuesit privatë ia dërguan listën e çmimeve KQZ-së dhe ata e informuan MVZ-në e ODIHR-it se nuk ishte blerë asnjë hapësirë reklamimi.⁷² Megjithatë, gjatë tre ditëve të fundit të fushatës, pesë transmetues privatë transmetuan falas reklama të PBD-së.⁷³ Vlera e hapësirës së ofruar falas nga disa media e tejkaloi kufirin e vendosur për dhurimet në natyrë për fushatë. Vlera e tregut e këtyre reklamave nuk u pasqyrua në raportet e ndërmjetme financiare të PBD-së.

Bordi *ad hoc* i Monitorimit të Medias (BMM) mbikqyr respektimin nga ana e mediave të Kodit Zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore. Megjithëse KQZ-ja duhet ta kishte ngritur BMM-në 40 ditë përpara fillimit të fushatës, ai u ngrit vetëm më 28 maj (32 ditë para). E ndihmuar nga AMA, BMM-ja filloi të monitorojë vetëm 14 kanale TV më 1 qershor, një ditë pas fillimit të fushatës.⁷⁴

⁶⁹ Duke bërë thirrje për tërheqjen e tyre, 10 organizata të njohura shqiptare në fushën e medias dhe të drejtave të njeriut [shprehën shqetësim](#) se këto ndryshime mund të “rrisnin [nivele] e censurës dhe autocensurës në mediat lokale dhe mund të çonin në hapa mbrapa sa i përket lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes në Shqipëri”. Më 15 gusht, Presidenti bëri një [deklaratë](#) ku shprehte shqetësimin për projektligjin anti-shpifje të propozuar nga qeveria. Shih, gjithashtu, edhe [deklaratën](#) dhe [analizën ligjore](#) të Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias.

⁷⁰ Më 30 maj, KQZ-ja i caktoi PS-së 60 minuta, Partisë Socialdemokrate 30 minuta, të gjitha partive të tjera joparlamentare që morën në pjesë në zgjedhje 10 minuta dhe kandidatëve të pavarur 5 minuta transmetim falas në radio-televizionin publik (RTSH).

⁷¹ Kodi Zgjedhor e kufizon minutazhin me pagesë të transmetimit në secilin transmetues privat për të gjithë fushatën në 90 minuta për partitë parlamentare dhe në 10 minuta për partitë joparlamentare dhe kandidatët e pavarur. Rekomandimi i vitit 2007 [CM/Rec\(2007\)15](#) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës u rekomandon të gjitha shteteve pjesëmarrëse që “të marrin masat që kuadri i tyre rregullues [...] t’u garantojë të gjitha partive garuese mundësinë e blerjes së hapësirës reklamuese në kushte të barabarta dhe më të njëjta tarifa pagese”.

⁷² Në këto lista çmimesh, shumica e mediave ofruan edhe hapësirë me pagesë në edicionet informative dhe në programet e aktualitetit.

⁷³ Disa media e informuan MVZ-në e ODIHR-it se i kishin ofruar minutazh transmetimi falas PBD-së ngaqë ajo nuk kishte fonde të mjaftueshme për të paguar për reklama. Disa nga këto media nuk paraqitën lista çmimesh në KQZ.

⁷⁴ KQZ-ja nuk e miratoi kërkesën e 3 qershorit të BMM-së për rekrutimin e më shumë punonjësve për monitorimin e një kampioni më të madh.

Kodi Zgjedhor kërkon që mediat audiovizive t'u japin të gjitha partive që kanë fituar më shumë se 20 përqind të mandateve në zgjedhjet e fundit për Kuvendin dyfishin e kohës në edicionet informative që marrin si mbulim partitë e tjera parlamentare, gjë që është në kundërshtim me angazhimet ndërkombëtare.⁷⁵ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it nga fusha e medias theksuan se BMM-ja nuk u kishte dhënë asnjë sqarim mediave se si duhet të vepronin në një situatë ku opozita bojkoton zgjedhjet. BMM-ja zgjodhi të monitoronte vetëm partitë që morën pjesë në zgjedhje dhe nuk qe, rrjedhimisht, në gjendje të vlerësonte plotësisht ekuilibrin e parashikuar me ligj në mbulimin e të gjitha partive parlamentare.

Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për t'u garantuar akses të barabartë në media të gjitha partive garuese në të gjitha llojet e programeve editoriale dhe për t'u dhënë mundësi të gjithë garuesve për të blerë hapësira reklamuese në kushte të barabarta. Mund të shihet gjithashtu mundësia për t'u dhënë të gjitha subjekteve zgjedhore një kohë të caktuar falas në mënyrë të barabartë.

BMM-ja i paraqiti dy raportet e saj të para javore vetëm më 18 qershor, pasuar nga raporti i tretë tre ditë më vonë.⁷⁶ Në këto raporte, BMM-ja propozoi në mënyrë arbitrare që KQZ-ja të urdhëronte që të gjitha 14 media e monitoruara të kompensojnë Partinë Socialdemokrate dhe 2 media të kompensojnë PBD-në me 30 minuta mbulim në edicionet e lajmeve. Ndonëse KQZ-ja urdhëroi më 22 qershor kryerjen e kompensimit, në raportin e katërt të paraqitur në KQZ më 28 qershor thuhej se mediat nuk e kishin përmbushur këtë urdhër. Raportet e BMM-së nuk përmbanin analiza dhe përmbanin në pjesën më të madhe të tyre informacione statistikore të përgatitura nga AMA, pasuar nga propozime të përgjithshme administrative. Disa raporte dhe rezultate monitorimi të BMM-së nuk u publikuan në faqen zyrtare të KQZ-së, duke minuar kështu transparencën.

Përgjegjësitë e BMM-së duhet të përcaktohen qartë. BMM-ja duhet të miratojë në kohën e duhur metodologjinë e monitorimit, dhe të publikojë pa vonesë raportet e saj të monitorimit të medias si dhe vendimet dhe lloje të tjera letrash dhe kërkesash drejtuar medias. BMM-së duhet t'i akordohen burime të mjaftueshme për monitorim më të hollësishëm të medias, duke përfshirë edhe transmetuesit vendorë.

Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it e kritikuan praktikën e përhapur dhe që egziston prej vitesh të ofrimit për median nga ana e partive politike kryesore dhe zyrtarëve publikë të regjistrimeve të gatshme ose të drejtpërdrejta të aktiviteteve zyrtare ose atyre të fushatës, ndërkohë që ato janë të mbyllura për median.⁷⁷ Ndonëse më 3 qershor BMM-ja u bëri thirrje mediave t'i etiketonin qartë dhe dukshëm të gjitha mbulimet e fushatës zgjedhore në edicionet informative të prodhuara nga partitë politike, këto transmetime vazhduan të ishin të pidentifikuara përgjatë gjithë fushatës, duke i keqorientuar me gjasë teleshikuesit rreth natyrës së tyre. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it theksuan se, në këto zgjedhje, aktivitetet zyrtare dhe aktivitetet e fushatës të Kryeministrit Rama u filmuan dhe u transmetuan përgjithësisht ekskluzivisht nga kanali ERTV me bazë Facebook-un, të cilat transmetuesit e tjerë kishin mundësi vetëm t'i ritransmetonin.⁷⁸ Praktika e kufizimit të aksesit të

⁷⁵ Paragrafi 7.8 i Dokumentit të vitit 1990 i Kopenhagenit i OSBE-së u kërkon Shteteve pjesëmarrëse "Të marrin masat në mënyrë që të asnjë grupim politik dhe individ që dëshiron të marrë pjesë në procesin zgjedhor të mos ketë asnjë pengesë ligjore apo administrative në aksesin e tij në media pa asnjë lloj diskriminimi". Paragrafi 8.5 i Rezolutës Nr. 1636 të vitit 2008 të Asamblesë Parlamentare të Evropës (PACE) thekson se "partitë politike dhe kandidatët duhet të kenë akses të drejtë dhe të barabartë në media".

⁷⁶ Duke filluar nga data 7 qershor, BMM-ja paraqiti në KQZ rezultate të përditshme të monitorimit.

⁷⁷ Shumë media kombëtare dhe rajonale u ankuan te MVZ-ja e ODIHR-it se nuk u lejohej të filmonin aktivitetet zyrtare dhe aktivitetet fushate ku përfshihej z. Rama.

⁷⁸ Zyra e Komunikimit të Kryeministrit e informoi MVZ-në e ODIHR-it se këto aktivitete janë gjithmonë të hapura për median, ndërkohë që filmimet e prodhuara nga kjo zyrë dhe nga partia kanë për qëllim thjesht t'i vijnë në ndihmë medias, dhe se i takon kësaj të fundit të zgjedhë t'i transmetojë ato ose jo.

medias në aktivitetet publike të organizuara nga zyrtarët e shtetit dhe partitë politike i ngushtoi mundësitë e zgjedhësve për të marrë informacione objektive gjatë fushatës. Ajo gjithashtu bie ndesh edhe me të drejtën themelore të medias për të marrë informacione dhe për të përmbushur funksionet e saj të monitorimit, duke sjellë si pasojë më pak llogaridhënie të zyrtarëve shtetërorë ndaj publikut.⁷⁹

Legjislacioni duhet të ndryshohet për të garantuar se mediat janë në gjendje të mbulojnë në mënyrë të pavarur aktivitetet e subjekteve zgjedhore garuese me qëllim kufizimin e përdorimit të përmbajtjes së prodhuar nga vetë partitë politike në edicionet informative dhe për të shmangur keqorientimin e zgjedhësve. Në çdo rast që media përdor përmbajtje të prodhuar nga partitë politike, ajo duhet të etiketohet qartësisht si e tillë.

C. GJETJET E MONITORIMIT TË MEDIAS

Rezultatet e monitorimit të medias nga MVZ-ja e ODIHR-it tregojnë se kjo fushatë e vakët mbeti në hije për shkak të krizës së vazhdueshme politike, me fokusimin e lajmeve dhe debateve televizive tek shkëmbimet gjithmonë e më të nxehta mes drejtuesve të PD-së dhe PS-së.⁸⁰ Kjo e ngushtoi gamën e informacioneve për garuesit, sidomos jashtë kryeqytetit, duke ua kufizuar në këtë mënyrë zgjedhësve mundësitë e bërjes së një zgjedhjeje të mirëinformuar. Përfundimisht të dukshëm bëri mbulimi mediatik i fushatës së kryetarit aktual të bashkisë së Tiranës dhe kandidatit të PS-së, Erion Veliaj, dhe prezantimet e kandidatëve të tjerë të PS-së nga Kryeministri Rama.

PS-ja dhe PD-ja dominuan mbulimin në edicionet informative në të gjitha mediat e monitoruara, ku e para mori 29 deri në 34 përqind, kurse e dyta 20 deri në 26 përqind të këtij mbulimi. Niveli i polarizimit u reflektua në tonin e mbulimit. Dy televizionet më të ndjekura, *Top Channel* dhe *TV Klan*, e mbuluan PS-në me tone kryesisht pozitive dhe neutrale, kurse PD-në me tone neutrale dhe negative. Në kontrast me to, *News 24* e mbuloi PS-në me tone negative dhe neutrale, kurse PD-në me tone neutrale dhe pozitive. Po kështu, *Vizion Plus* e mbuloi PD-në në një mënyrë pozitive dhe neutrale, kurse PS-në në mënyrë më të ekuilibruar dhe në një raport të barabartë mbulimi pozitiv dhe negativ. Kanali publik, *RTSH-1* ishte disi më neutral, ku PS-ja u mbulua në një mënyrë neutrale dhe pozitive, kurse PD-ja me ton neutral.⁸¹

Ashtu si edhe edicionet informative, edhe debatet dhe programet e aktualitetit në *Top Channel*, *News 24* dhe *RTSH-1* pasqyruan politikën editoriale të mediave përkatëse, Ndërkohë që *Top Channel* dhe *RTSH-1* shërbyen kryesisht si platformë për promovimin e PS-së, debatet në *News 24* ishin kritike ndaj partisë qeverisëse. Megjithatë, emisioni i debatit “Opinion” në *TV Klan* ndryshonte nga mbulimi në edicionet informative në këtë media, duke shërbyer si platformë kritikash ndaj PS-së. Emisionet e debatit dhe programet e aktualitetit në *Vizion Plus* i kushtuan pothuajse dyfishin e kohës PS-së krahasuar me kohën që i dhanë PD-së, përkatësisht 44 dhe 23 përqind, ku toni ishte në pjesën më të madhe neutral për të dyja partitë.

⁷⁹ E drejta për të marrë dhe për të dhënë informacione garantohet nga neni 19 i [Deklaratës Universale të vitit 1948 për të Drejtat e Njeriut](#). Paragrafi 26 i Konventës Ndërkombëtare së OKB-së për të Drejta Politike dhe Civile (KNDPC) të vitit 1996, [Komenti i Përgjithshëm Nr. 25](#) për Nenin 25 të KNDPC-së thotë se: “Komunikimi i lirë i informacioneve dhe ideve rreth çështjeve publike dhe politike mes qytetarëve, kandidatëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur është thelbësor. Kjo nënkupton një shtyp dhe media të tjera të lira që janë në gjendje të komentojnë për çështje publike, pa censurë apo kufizime dhe të informojnë opinionin publik”.

⁸⁰ MVZ-ja e ODIHR-it monitoroi mbulimin gjatë kohës me shikueshmërinë më të lartë në pesë stacione televizive (kanali *RTSH-1* i radio-televizionit publik dhe kanalet private *News 24*, *Top Channel*, *TV Klan* dhe *Vizion Plus*) dhe ndoqi dy burime online (*Panorama* dhe *syri.net*)

⁸¹ RTSH-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se mbulimi i partive opozitare dhe i protestave të tyre ishte më i dukshëm në kanalën e hapur së fundmi informativ 24-orësh, *RTSH-24*.

Ndërkohë që portali informativ *Panorama* i kushtoi më shumë hapësirë PS-së sesa PD-së, 33 përqind të parës dhe 24 të dytës, ai e kritikoi rëndë PS-në dhe qeverinë, ndërkohë që PD-në e mbuloi me tone kryesisht neutrale dhe pozitive. *Syri.net* shfaqti një njëanshmëri të qartë kundër PS-së, qeverisë dhe kryetarit të bashkisë së Tiranës, duke mbuluar ndërkohë me tone të favorshme PD-në. Që të dyja këto faqe interneti i kushtuan hapësira të konsiderueshme mbulimi neutral, përkatësisht shtatë dhe nëntë përqind, LSI-së.

Gratë kandidatë dhe gratë politikane patën mbulim shumë të kufizuar gjatë fushatës. Ndonëse më shumë se 11 përqind e kandidatëve për kryetare bashkie dhe gjysma e kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë ishin gra, të gjitha mediat private u kushtuan atyre gjatë fushatës vetëm 3 deri në 11 përqind të mbulimit. Ndonëse *RTSH-1* u kushtoi disi më shumë kohë grave (17 përqind), edhe programet e tyre informative dhe emisionet e aktualitetit u dominuan nga politikanët burra.

XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Ligji parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për personat që u përkasin pakicave kombëtare dhe u garanton të drejtën për të votuar dhe për të kandiduar në zgjedhje të gjithë shtetasve, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike, racës, besimit fetar ose gjuhës. Fushata lejohet të bëhet në gjuhët e pakicave kombëtare dhe u konstatua në disa bashki, sidomos në Pustec dhe Finiq. Ndonëse aktet zyrtare të administratës zgjedhore dalin vetëm në gjuhën shqipe, MVZ-ja e ODIHR-it konstatoi zhvillimin e diskutimeve në nivel pune në gjuhën e një pakice kombëtare në mbledhjen e një KZAZ-je.

Nuk u vërejt asnjë rast i diskriminimit të drejtpërdrejtë ndaj pakicave kombëtare gjatë procesit zgjedhor. Megjithatë, disa aktivistë dhe kandidatë të partive politike nga pakicat kombëtare rome dhe egjiptiane i shprehën shqetësimin MVZ-së së ODIHR-it se rolet dhe kontributet e tyre nuk vlerësoheshin sa duhet nga drejtuesit e partive ose koalicioneve përkatëse. Ata u shprehën se e njëjta gjë vlen edhe në tërësi për komunitetet e tyre, për të cilat ata ngarkohen nga përfaqësuesit e partive që t'i bindin të votojnë për një parti të caktuar, ose përndryshe, të mos votojnë fare.⁸² Duke qenë se disa parti të pakicave kombëtare vendosën t'i bashkoheshin bojkotimit të zgjedhjeve, në disa komunitete ku pakicat kombëtare mund të paraqesin zakonisht kandidatë, zgjedhësve nuk iu dha kjo mundësi.⁸³

Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen (MEGA), e cila nuk kandidoi si pjesë e ndonjë koalicioni, nuk e rikandidoi kryetarin e bashkisë së Finiqit, i cili kandidoi si i pavarur. Kryeministri bëri fushatë për kandidatin e MEGA-s, i cili fitoi. Në Pustec, kryetari aktual i bashkisë që përfaqëson Partinë Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Evropian u mund nga kandidati i PS-së.

KQZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se kishte prodhuar materiale për edukimin e zgjedhësve në lidhje me funksionimin e sistemit zgjedhor dhe procedurave të votimit në gjuhët e pakicave kombëtare, gjë që kërkohet pjesërisht nga Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Megjithatë, MVZ-ja e ODIHR-it nuk hasi asnjë material të tillë dhe asnjë nga bashkëbiseduesit nuk raportoi të kishte parë të tilla materiale nëpër bashki.

⁸² Në Shkodër, një kandidat rom zuri vendin e fundit në listën e PS-së; në Vlorë, vendin e parafundit; në Fier, vendin e 30^{të}; në Gjirokastrë, një kandidat egjiptian zuri vendin e 28^{të}. Ndryshe nga këto, një kandidat i pakicës kombëtare egjiptiane u vendos në vend të 9^{të} në listën e PS-së të kandidatëve për anëtar të këshillit bashkiak në Berat.

⁸³ Një kandidat etnik grek për kryetar bashkie në Himarë, Dhionisios Alfred Beleri, iu mohua regjistrimi nga KQZ-ja për shkak të një dënimi të tij në të kaluarën. Në shqyrtimin e apelimit të tij, më 30 maj, Kolegji Zgjedhor e la në fuqi vendimin e KQZ-së dhe vendosi se z. Beleri nuk e ka të drejtën të kandidojë deri në vitin 2021.

Me mbështetje ndërkombëtare, KQZ-ja zhvilloi disa programe edukimi që kishin në qendër komunitetet rome dhe egjiptiane. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it raportuan se këto komunitete mbeten të prekshëm nga praktikatat e shitblerjes së votave dhe se hasin vazhdimisht probleme me regjistrimin si zgjedhës, sepse disa prej anëtarëve të tyre nuk kanë një adresë të përhershme. MVZ-ja e ODIHR-it mori raportime për shpërndarje mallrash në komunitete rome dhe egjiptiane, të cilat bashkëbisedues të ndryshëm i konsideronin si një mënyrë për të influencuar zgjedhjen e tyre për të marrë ose jo pjesë në zgjedhje.

XII. ANKIMET DHE APELIMET

Kodi Zgjedhor parashikon një sistem ankimesh administrative ndaj vendimeve të KQV-ve dhe KZAZ-ve, si dhe apelime gjyqësore ndaj vendimeve të KQZ-së. Zgjedhësit mund të ankohen ndaj gabimeve në listat e zgjedhësve duke iu drejtuar gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës. Çdo parti politike dhe çdo kandidat ka të drejtë të ankohet në KQZ ndaj vendimeve të KZAZ-ve që prekin interesat e tyre të ligjshëm brenda tre ditësh nga shpallja e tyre. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të apelojnë në Kolegjin Zgjedhor vendimet e KQZ-së që prekin interesat e tyre të ligjshme; palët që nuk marrin pjesë në zgjedhje nuk mund të hapin çështje gjyqësore në Kolegjin Zgjedhor. Grupet e vëzhguesve vendas mund të ankohen vetëm ndaj vendimeve të KZAZ-ve dhe vendimeve të KQZ-së që u mohojnë akreditimin. Rezultatet e zgjedhjeve në një qendër specifike votimi, në një zonë zgjedhore apo bashki mund të shpallen të pavlefshme nga KQZ-ja me kërkesë të subjekteve zgjedhore ose *ex officio*, dhe kundër këtyre vendimeve mund të apelohej më tej në Kolegjin Zgjedhor.

KQZ-ja i miraton vendimet në lidhje me ankimet në mbledhje të hapura brenda dy ditësh, dhe i publikon vendimet e arsyetuara në faqen e saj zyrtare brenda 24 orësh. Ankuesit nuk njoftohen rreth vendimit përmes një njoftimi me shkrim dhe, në disa raste, kur vendimet e KQZ-së u publikuan me vonesë, disa prej tyre e humbën afatin 5 ditor për paraqitjen e apelimit në Kolegjin Zgjedhor.⁸⁴ Më 30 maj dhe 6 qershor, Kolegji Zgjedhor vendosi se KQZ-ja nuk është e detyruar t'ua komunikojë vendimet e saj palëve me shkrim, dhe se janë këto të fundit që duhet të dërgojnë përfaqësuesit e tyre në mbledhjet përkatëse të KQZ-së ose përndryshe të informohen rreth vendimit përmes faqes zyrtare të KQZ-së. Kështu, procedura e njoftimit të ankuesve dhe e publikimit të vendimeve të KQZ-së në lidhje me ankimet nuk është gjithmonë efiçente apo e favorshme për zgjidhje efikase, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së.⁸⁵

Kolegji Zgjedhor, autoriteti më i lartë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore, përbëhet nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur për 4 vjet me short nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Për shkak të procesit aktual të “*vetting*-ut të gjyqtarëve”, Kolegji Zgjedhor përbëhej nga vetëm 6 anëtarë gjatë periudhës zgjedhore.⁸⁶ Vendimet e Kolegjit Zgjedhor, të cilat duhet të merren brenda 10 ditësh, janë të formës së prerë.⁸⁷

⁸⁴ MVZ-ja e ODIHR-it e mori këtë informacion nga Partia Aleanca Kuq e Zi, Partia e Aleancës Demokristiane dhe Partia Konservatore Kombëtare e Shqipërisë.

⁸⁵ Paragrafi 5.10 i Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagenit i vitit 1990 shprehet se “Çdo njeri duhet të ketë mjete efikase ankimi ndaj vendimeve administrative, në mënyrë që të garantohet respektimi i të drejtave themelore dhe të sigurohet integriteti juridik”.

⁸⁶ *Vetting*-u i gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili është pjesë e reformës në drejtësi që është në vazhdim e sipër, vlerëson integritetin, pasurinë dhe profesionalizmin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. *Vetting*-u ka çuar në shumë shkarkime dhe dorëheqje, duke ndikuar kështu në funksionimin e shumë gjykatave dhe prokurorive, duke e lënë veçanërisht Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë pa kuorumin që u nevojitet për të qenë funksionale.

⁸⁷ Kushtetuta i jep juridiksion Gjykatës Kushtetuese për shkeljet e të drejtave dhe lirive kushtetuese, por në praktikë, ky juridiksion nuk ushtrohet sa i përket të drejtave zgjedhore.

Ndonëse vendimi i Kolegjit Zgjedhor shpallet në mbledhje të hapura për publikun, vendimi i plotë i arsyetuar është i aksesueshëm vetëm në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit të Tiranës për personat që kanë një fjalëkalim të veçantë, gjë që nuk e lehtëson informimin e publikut të gjerë rreth rregullave të procesit zgjedhor dhe nuk kontribuon në transparencën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore. Vendimet e arsyetuara të Kolegjit Zgjedhor u jepen palëve ose drejtpërdrejt në gjykatë ose u dërgohen me postë rekomandë, e cila mund të bëhet subjekt vonesash.

Për garantuar transparencën e rezultateve të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore, të gjitha vendimet e Kolegjit Zgjedhor mund të publikohen në mënyrë të menjëhershme dhe të jenë të aksesueshme për të gjithë.

Si KQZ-ja, ashtu edhe Kolegji Zgjedhor, i respektuan afatet kohore të parashikuara me ligj për gjykimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Deri më 30 qershor, KQZ-ja mori 16 ankime ndaj vendimeve të KZAZ-ve, kryesisht në lidhje me regjistrimin e kandidatëve. Si rrjedhojë e zgjidhjes së ankimeve ndaj mosregjistrimit të kandidatëve nga KZAZ-të, KQZ-ja reregjistroi 11 kandidatë. Ndaj 13 vendimeve të KQZ-së u paraqit apelim në Kolegjin Zgjedhor, i cili rrëzoi tre dhe la në fuqi dhjetë prej tyre.⁸⁸ Kolegji Zgjedhor përgjithësisht e respektoi procesin e rregullt ligjor, duke i dëgjuar palët në mbledhje të hapura dhe duke i shpallur vendimet publikisht. Interpretimi i ngushtë i Kolegjit Zgjedhor i legjitimitetit të subjekteve garuese për të kundërshtuar regjistrimin e garuesve të tjerë ndikoi në të drejtën e tyre për t'u ankuar ndaj ligjshmërisë së regjistrimit të kandidatëve.⁸⁹ Kjo ngre gjithashtu shqetësime në lidhje me aksesin në zgjidhje ligjore efikase.

Më 13 qershor, KQZ-ja hodhi poshtë kërkesën e Partisë së Unitetit Kombëtar për t'u tërhequr nga zgjedhjet, duke arsyetuar *inter alia* se dekreti i 10 qershorit i Presidentit që anulonte zgjedhjet ishte i pavlefshëm. Më 24 qershor, Kolegji Zgjedhor e hodhi poshtë apelimin ndaj këtij vendimi të KQZ-së, duke e vlerësuar gjithashtu dekretin e Presidentit të 10 qershorit si të pavlefshëm.⁹⁰

Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me mungesën e paanshmërisë së KQZ-së, duke vënë në pah raste ku shumica e anëtarëve të KQZ-së kishin votuar sipas linjave partiake.⁹¹ Ndonëse gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor gëzojnë imunitet dhe nuk mund të jenë objekt procedimesh disiplinore përgjatë gjithë mandatit të funksionimit të Kolegjit, ata janë objekt i “procesit të *vetting*-ut” që është në vazhdim e sipër, i cili mund të ndikojë në sigurinë e vazhdimësisë së tyre si gjyqtarë dhe, rrjedhimisht, mund të ndikojë në pavarësinë e tyre.

Të gjitha gjykatat që kanë kompetencë në fushën e zgjedhjeve duhet të jenë plotësisht funksionale gjatë periudhave zgjedhore. Duhet të garantohen pavarësia dhe paanshmëria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e gjyqësorit.

⁸⁸ Vendimet e lëna në fuqi përfshinë ato që kishin të bënin me të drejtën e partive politike që nuk merrnin pjesë në zgjedhje për të propozuar anëtarë në administratën zgjedhore, legjitimitimin e partive politike në rastet e kundërshtimit të regjistrimit të garuesve të tjerë, regjistrimin e kandidatëve, mospranimin e kërkesave të kandidatëve për t'u tërhequr nga zgjedhjet, si dhe vendndodhjet e qendrave të votimit.

⁸⁹ Në vendimin e tij të 9 majit mbi ankimin ndaj regjistrimit të PBD-së, Kolegji Zgjedhor vlerësoi se ankuesi, Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar dhe partitë e tjera pjesëmarrëse në zgjedhje nuk kishin asnjë interes legjitim për të kundërshtuar ligjshmërinë e regjistrimit të partive të tjera garuese dhe se, për këtë arsye, nuk mund t'i apelonin vendimet e KQZ-së në lidhje me këtë. Seksioni 3.3.f i Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të vitit 2002 të Komisionit të Venecias rekomandon se “Të gjithë kandidatët [...] të regjistruar në zonën zgjedhore përkatëse duhet të kenë të drejtë të ankohen”.

⁹⁰ Dy gjyqtarë shprehën opinione paralele, duke argumentuar se Kolegji Zgjedhor nuk ka kompetencën e rishikimit të statusit të dekretit të Presidentit.

⁹¹ Seksioni 3.1 a i Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të vitit 2002 të Komisionit të Venecias rekomandon se “Zbatimi i ligjit zgjedhor duhet të jetë përgjegjësi e një organi të pavarur”.

Deri më 9 korrik, Prokuroria e Përgjithshme raportoi 18 procedime të filluara në lidhje me vepra penale në fushën e zgjedhjeve, të cilat përfshinin 75 persona gjithsej të ndaluar ose të arrestuar.⁹² Akuzat përfshinin bërjen e thirrjeve publike për dhunë, organizimin e tubimeve të paligjshme ose pjesëmarrje në to,⁹³ bllokimin e rrugëve, shkatërrimin e pronës me lëndë shpërthyes, pengimin e administratës zgjedhore dhe shkatërrimin e materialeve zgjedhore, si dhe moszbatimin e urdhrave të policisë. Partitë opozitare i konsideruan si të motivuara politikisht disa prej këtyre rasteve.

Ndonëse MVZ-ja e ODIHR-it qe dëshmitare e disa rasteve të intimidimit të zgjedhësve dhe shkeljes së fshehtësisë së votës në qendrat e votimit dhe u vu në dijeni për raste të ngjashme nga partitë politike, zyrtarisht nuk u regjistrua asnjë rast i tillë, për shkak të - siç u raportua - mungesës së ankesave të qytetarëve në polici. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime rreth mungesës në përgjithësi të efikasitetit të hetimeve penale, gjë që kontribuon në perceptimin e përhapur gjerësisht të pandëshkueshmërisë për krime zgjedhore në të kaluarën, duke përfshirë shitblerjen e votave dhe ushtrimin e presionit mbi zgjedhësit.

Organet e zbatimit të ligjit duhet të hetojnë në mënyrë të plotë, të menjëhershme dhe transparente çdo akuzë për shkelje zgjedhore. Qeveria duhet të përcaktojë një procedurë përmes së cilës punonjësit aktualë apo të mundshëm të administratës publike të mund të raportojnë çdo rast presioni politik mbi ta në lidhje me marrjen apo mbajtjen e një posti ose në lidhje me vlerësimin e performancës së tyre në punë. Këta persona duhet të gëzojnë mbrojtjen që ligji ua garanton aktualisht sinjalizuesve.

XIII. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin e zgjedhjeve si nga vëzhgues vendas, ashtu edhe nga vëzhgues ndërkombëtarë në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Partitë parlamentare dhe koalicionet mund të caktojnë përfaqësues të përhershëm në KQZ, kurse partitë e tjera kanë të drejtë të caktojnë përfaqësues vetëm gjatë periudhës zgjedhore. Subjektet zgjedhore që garojnë kanë të drejtë të caktojnë nga një vëzhgues në çdo KZAZ, KQV dhe VNV përkatëse. E drejta e caktimit të vëzhguesve që përfaqësojnë koalicionet u takon vetëm koalicioneve dhe jo partive politike pjesë përbërëse të tyre.

Për këto zgjedhje, KQZ-ja regjistroi 494 vëzhgues ndërkombëtarë, si dhe 630 vëzhgues vendas nga gjashtë organizata. Ndonëse nuk u ngrit asnjë problem në lidhje me akreditimin e vëzhguesve vendas, disa OJQ e informuan MVZ-në e ODIHR-it se do të tërhiqeshin kësaj here nga aktivitetet e vëzhgimit të zgjedhjeve dhe të edukimit të zgjedhësve për të mos u perceptuar sikur po shprehnin preferenca politike përmes angazhimit në procesin zgjedhor.

Ligji i detyron KQV-të dhe KZAZ-të të pajisin me procesverbalet e qendrave të votimit për procesin e votimit dhe mbylljen tyre si dhe me tabelat e nxjerrjes së rezultateve vetëm vëzhguesit e partive dhe të koalicioneve dhe jo vëzhguesit vendas apo ndërkombëtarë, duke e kufizuar kështu mundësinë e këtyre të fundit për të mbikëqyrur me efikasitet proceset e numërimit dhe të nxjerrjes së rezultateve.

⁹² Tre procedime penale u ndërmorën në Shkodër, dy në Dibër, dy në Elbasan, dy në Mat, dy në Tiranë dhe një në secilin prej bashkive Durrës, Fier, Kavajë, Korçë, Kurbin, Pogradec dhe Tropojë. Në shumicën e rasteve, në procedim përfshiheshin më shumë se një i dyshuar.

⁹³ Për mbajtje tubimesh, organizatorët janë të detyruar të njoftojnë me shkrim policinë jo më vonë se tre ditë para datës së tubimit (tre orë në rast tubimesh urgjente). Policia duhet të garantojë rendin publik dhe sigurinë gjatë tubimeve.

XIV. DITA E ZGJEDHJEVE

Votimi u zhvillua në një sfond njoftimesh të bëra nga shumica e bashkive të drejtuara nga kryetarët opozitarë se zgjedhjet nuk do të zhvilloheshin më 30 qershor. Disa kryetarë bashkie tentuan t'i përdornin kompetencat e tyre për të mos lejuar përdorimin e ndërtesave publike si qendra votimi. Si rrjedhojë, administrata zgjedhore zgjodhi të kërkonte përdorimin e ambienteve me pronësi private për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në disa zona. Në ditën e zgjedhjeve, KQZ-ja konfirmoi se votimi nuk u zhvillua në 7 qendra votimi.⁹⁴

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht paqësore, pavarësisht disa tensioneve dhe përplasjeve të izoluara në një numër të vogël komunitetesh.⁹⁵ Pjesëmarrja në votim varioi nga një bashki në tjetrën dhe shifra e publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së u rishikua disa herë para se të përcaktohej zyrtarisht në 22.96 përqind.⁹⁶

Procedurat e hapjes së qendrave të votimit u vëzhguan nga MVZ-ja e ODIHR-it në 73 qendra votimi, kurse procesi i votimit në 743 qendra votimi në 85 ZAZ. Mbyllja u vëzhguara në 69 qendra votimi, kurse numërimi në 85 VNV. Prania e vëzhguesve të partive politike, e konstatuar në më shumë se dy të tretat e qendrave të vizituara të votimit, kryesisht nga PS-ja, dhe e vëzhguesve vendas, konstatuar në një të pestën e këtyre qendrave, kontribuoi në transparencën e procesit. Megjithatë, disa vëzhgues partish ose aktivistë u panë, hera-herës, të ndërhyenin në administrimin e procesit.⁹⁷

Hapja e procesit u vlerësua negativisht në 9 nga 73 qendra të vëzhguara të votimit. Në më shumë se gjysmën e qendrave të vëzhguara të votimit, votimi u hap me vonesë, në pjesën më të madhe me një vonesë jo më shumë se 15 minuta. Procedurat e hapjes u ndoqën përgjithësisht, por MVZ-ja e ODIHR-it evidentoi se në 11 raste, anëtarët e KQV-ve nuk dukeshin të familjarizuar me procedurat e hapjes; për shembull, në 10 qendra votimi, procesverbalet e vulosjes nuk u vendosën brenda kutisë së fletëve të votimit.

Votimi ishte përgjithësisht i qetë dhe u vlerësua pozitivisht në 95 përqind të vëzhgimeve nga MVZ-ja e ODIHR-it. Vlerësimet negative erdhën pjesërisht për shkak të moskontrollimit gjithmonë të zgjedhësve për gjurmë boje (21 përqind të vëzhgimeve) dhe mosshenjimit të tyre gjithmonë me bojë para se t'u jepej fleta e votimit (10 përqind). Firma në dukje identike, tregues të votimit me prokurë, dhe raste personash që tentonin të influencenin zgjedhësit, u konstatuan secila në 3 përqind të vëzhgimeve. Votimi në grup ose votimi familjar dhe votimi me prokurë u konstatuan përkatësisht në 10 përqind dhe 2 përqind të vëzhgimeve; kjo ngre shqetësime dhe tregon se rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it në lidhje me garancitë ndaj votimit familjar nuk janë adresuar në mënyrë efikase. Në 16 përqind të vëzhgimeve, MVZ-ja e ODIHR-it evidentoi raste ku i njëjti person u ofronte ndihmë disa zgjedhësve të ndryshëm.

Zgjedhësit u kthyen mbrapsht në më shumë se 23 përqind të qendrave të vëzhguara të votimit, kryesisht për arsye të vlefshme, ku përfshiheshin përcjellja e tyre në qendra të tjera votimi në përafërsisht dy të tretat e këtyre rasteve. Ky ishte një tregues i ndikimit të ndryshimeve të fundit të

⁹⁴ MVZ-ja e ODIHR-it vërejtë moszhvillimin e votimit në të paktën 12 qendra votimi, duke përfshirë 8 qendra në KZAZ-në nr. 2, 3 në KZAZ-në nr. 4 dhe 1 në KZAZ-në nr. 78.

⁹⁵ MVZ-ja e ODIHR-it konstatoi tensione ose rrëmuja jashtë qendrave të votimit në 1.8 përqind të rasteve, kurse brenda qendrave të votimit në 1.1 përqind të rasteve të vëzhguara.

⁹⁶ Pjesëmarrja më e ulët në zgjedhje u shënuar në Shkodër (10.3 përqind), kurse më e larta në Pustec (55.5 përqind). Përfaqësuesit e PD-së i kundërshtuan publikisht në disa raste shifrat zyrtare të pjesëmarrjes.

⁹⁷ Ndonëse ndërhyrje nga persona të paautorizuar u vunë re në më pak se katër përqind të qendrave të vëzhguara të votimit, disa vëzhgues të MVZ-së së ODIHR-it raportuan se disa vëzhgues të PS-së nuk dalloheshin nga anëtarët e KQV-ve. Vëzhguesit vendas dukeshin si të lidhur me partitë politike në pesë përqind të rasteve.

vendndodhjes së qendrave të votimit për shkak të bllokimit të tyre nga aktivistët e opozitës, por edhe i një sistemi jo të mirë tabelash orientuese. Vulat e sigurisë të kutive të fletëve të votimit nuk u regjistruan në librat e shënimeve të mbledhjeve të KQV-ve në 8 përqind të rasteve dhe informacioni për procedurat e votimit nuk u afishua në vende të dukshme në pothuajse 14 përqind të vëzhgimeve.

Planvendosja e qendrave të votimit ishte e papërshtatshme në 6 përqind të rasteve dhe nuk krijonte mundësi për fshehtësinë e votës në 5 përqind të vëzhgimeve. Në 10 përqind të vëzhgimeve, zgjedhësit nuk e bënë shënimin në fletën e tyre të votimit në fshehtësi; ndërkohë, në 11 përqind të vëzhgimeve, zgjedhësit nuk e palosën fletën e votimit për të garantuar fshehtësinë e votës. Sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, disa zgjedhës kishin frikë se vetë pjesëmarrja në zgjedhje do të bënte të ditur preferencën e tyre politike, sidomos aty ku kandidatët e PS-së garonin pa kundërshtarë. Në shumë raste, aktivistët e partive politike (kryesisht të PS-së, por edhe të PD-së) mbanin shënim zgjedhësit që merrnin pjesë, duke sfiduar të drejtën e zgjedhësve për të votuar të lirë dhe pa frikën e ndëshkimit.

Autoritetet duhet të garantojnë të drejtën e zgjedhësve për të zgjedhur në mënyrë të lirë dhe të fshehtë. Procedurat e votimit duhet të rishikohen për të garantuar fshehtësinë e votës dhe mbrojtjen nga çdo ndikim i papërshtatshëm ndaj zgjedhësve. Rëndësia e fshehtësisë së votës duhet të theksohet gjatë trajnimit të komisioneve zgjedhore dhe në materialet e edukimit të zgjedhësve.

Autoritetet nuk morën masa të përshtatshme për të garantuar pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe si kandidatë në procesin zgjedhor. Në dy të tretat e vëzhgimeve, qendrat e votimit nuk krijuan mundësi për akses të pavarur për zgjedhësit me aftësi të kufizuar lëvizjeje. Në 71 përqind të vëzhgimeve, planvendosja e qendrave të votimit nuk ishte e përshtatshme për zgjedhësit me aftësi të kufizuar. Kjo pengesë bie ndesh me detyrimin ndërkombëtar për garantimin e të drejtës së barabartë të votës për të gjithë zgjedhësit.⁹⁸

Autoritetet duhet të marrin një rol proaktiv për garantimin e aksesueshmërisë në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuar. Ambientet ku mungon aksesimi duhet të identifikohen kohë më parë dhe, sipas nevojës, duhet të ofrohen zgjidhje alternative.

Mbyllja e votimit u vlerësua negativisht në 7 nga 69 vëzhgime, për shkak të mbylljes me vonesë të tij. Në pothuajse të gjitha vëzhgimet, procedurat e mbylljes u ndoqën me korrektesë dhe KQV-të i transferuan materialet në VNV pa vonesë. Në të gjitha rastet, përveçse në 5 prej tyre, materialet arritën në VNV brenda afatit prej tre orësh pas mbylljes së votimit, parashikuar me ligj. Transferimi dhe marrja në dorëzim e materialeve u vlerësuan pozitivisht në të gjitha rastet përveçse në dy prej rasteve të vëzhguara. Në 16 raste, ambientet e VNV-ve ishin të mbipopulluara dhe në 12 raste u konsideruan të papërshtatshme për dorëzimin e materialeve nga KQV-të, kryesisht për shkak të hapësirës së pamjaftueshme ose masave të pamjaftueshme të sigurisë. 14 kuti fletësh votimi të marra në dorëzim u shpallën të parregullta, midis të tjerash për shkak të mungesës ose dëmtimit të vulës, por vetëm gjysma e këtyre rasteve u regjistruan si duhet.

Numërimi dhe nxjerrja e rezultateve u vlerësuan pozitivisht në të gjitha vëzhgimet përveçse në 9 prej 100 vëzhgimeve gjithsej, pjesërisht për shkak të mosndjekjes gjithmonë me korrektesë të disa procedurave.⁹⁹ Konkretisht, numërimi i votave u ndërpre në 20 raste (19 KZAZ të ndryshme), fletët e

⁹⁸ Neni 29(a) i Konventës së të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar i detyron shtetet “të marrin masa që personat me aftësi të kufizuar të mund të marrin pjesë efektivisht dhe plotësisht në jetën politike dhe publike në mënyrë të barabartë me të tjerët, duke u kujdesur... *inter alia*, që procedurat e votimit, ambientet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta ... për t’u përdorur”.

⁹⁹ Sa i përket verifikimit të materialeve zgjedhore, procesverbalet e mbylljes së votimit nuk u gjetën gjithmonë brenda kutisë së votimit në 19 raste (18 KZAZ). Në më shumë se gjysmën e rasteve ku ndodhi kjo, procesverbalet u gjetën në kutinë e materialeve zgjedhore.

votimit nuk u shpалosën gjithmonë dhe vulat nuk u ekspozuan gjithmonë ndaj kamerave në 24 raste (18 KZAZ), si dhe faqja ballore e fletës së votimit nuk u ekspozua gjithmonë ndaj kamerës në 19 raste (13 KZAZ). Numri total i fletëve të votimit të hedhura në kuti nuk u numërua dhe nuk u krahasua me numrin e firmave të hedhura në listat e zgjedhësve në 18 raste (13 KZAZ); po kështu, votat për të gjitha partitë ose kandidatët nuk u numëruan dhe nuk u shpallën në 17 raste (12 KZAZ). Kopje të tabelës së rezultateve për qendrat e votimit nuk iu dhanë vëzhguesve të partive në 24 raste (18 KZAZ). Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it theksuan se ajo që ul besimin e zgjedhësve në proces dhe që mund të jetë objekt abuzimi është praktika e numërimit të fletëve të votimit në VNV dhe jo drejtpërdrejt në qendrat e votimit.

XV. ZHVILLIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE

Deklaratat e aktorëve kryesorë politikë menjëherë pas zgjedhjeve pasqyruan në mënyrë të vazhdueshme përçarjet e thella. Presidenti falënderoi të gjithë “ata që nuk ranë viktimë e retorikës konfrontuese të drejtuesve të papërgjegjshëm, të cilët përmes nxitjes së dhunës, duan të fshehin skandalet dhe moslogaridhënien e tyre”.¹⁰⁰ Kryetari i PD-së deklaroi se “votimi nuk e zgjidhi, por e thelloi krizën”.¹⁰¹ Duke iu referuar 6 muajve të fundit si një “plagë e hapur” që kërkon shërim, Kryeministri ofroi bashkëpunim dhe theksoi se “marrëveshja mund të ndërtohet vetëm përmes një dialogu pa kushte dhe duke shprehur pa hezitim gatishmërinë për t’u angazhuar dhe për të punuar së bashku për të kontribuar në hapjen e negociatave për aderimin në Bashkimin Evropian”.¹⁰²

Pas zgjedhjeve, PBD-ja depozitoi ankime në KQZ duke kërkuar shpalljen të pavlefshme të rezultatit të zgjedhjeve në 40 bashki, duke pretenduar se kishte një diferencë të konsiderueshme mes shifrave të pjesëmarrjes zyrtare të zgjedhësve në zgjedhje dhe të dhënave të raportuara nga vëzhguesit e PBD-së. Në periudhën 10-15 korrik, KQZ-ja i hodhi poshtë të gjitha këto ankime për shkak të mungesës së provave, duke lënë kështu në fuqi rezultatet e miratuara nga KZAZ-të përkatëse dhe nga KQZ-ja. Në KQZ u dorëzuan edhe pesë ankime të tjera në lidhje me rezultatet nga Partia e Emigracionit Shqiptar, Partia e Aleancës Demokratike, Partia Kombëtare Konservatore (PKK) dhe nga dy kandidatë të pasuksesshëm për kryetarë bashkie. Të gjitha këto ankime ose u rrëzuan ose nuk u pranuan për shkak të mosplotësimit të kriterëve për ankim.¹⁰³

KQZ-ja i miratoi rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë bashkie dhe për këshilla bashkiakë në të gjitha bashkitë në 11 korrik. Ligji kërkon që mandatet për anëtarët e këshillave bashkiakë të miratohen me shumicën e cilësuar të pesë anëtarëve të KQZ-së. Ndonëse KQZ-ja i vendosi rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë bashkie me 4 vota, ajo nuk arriti të ndante mandatet e anëtarëve të këshillave bashkiakë, duke qenë se kryetari i KQZ-së votoi kundër. Pas përfundimit të afatit të KQZ-së për ndarjen e mandateve të anëtarëve të këshillave bashkiakë, PS-ja depozitoi apelime në Kolegjin Zgjedhor për t’i hapur rrugën konstituimit të këshillave të rinj bashkiakë dhe betimit të kryetarëve të rinj të bashkive. Kolegji i pranoi këto apelime dhe mori në dorë shpërndarjen e mandateve për të gjithë 61 këshillat bashkiakë në periudhën 22-26 korrik.¹⁰⁴ Më 27 korrik, KQZ-ja miratoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve me katër vota, ndërkohë që kryetari i KQZ-së votoi kundër, duke i qëndruar bindjes se zgjedhjet e 30 qershorit ishin anuluar nga Presidenti.

¹⁰⁰ Shih [deklaratën](#) e Presidentit të datës 1 korrik.

¹⁰¹ Lulzim Basha [e përshkroi](#) kombin “më të bashkuar se kurrë, jo rreth një partie, por rreth vlerave evropiane”.

¹⁰² Kryeministri [shtoi](#): “Reforma zgjedhore sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe rekomandimeve të Këshillit Evropian mbetet sfidë e përbashkët si për opozitën parlamentare, ashtu edhe për atë joparlamentare”.

¹⁰³ Pas pranimit për shqyrtim të ankimit nga PKK-ja, KQZ-ja rinumëroi 11 kuti fletësh votimi nga Lezha dhe gjeti mospërputhje të vogla.

¹⁰⁴ Në të njëjtën kohë, Kolegji Zgjedhor i rrëzoi të pesta apelimet e PBD-së kundër mospranimit nga KQZ-ja të shpalljes së pavlefshme të rezultateve të zgjedhjeve në pesë bashki, si dhe një apelim të ngjashëm të një kandidati të pavarur.

Të paktën tre kryetarë aktualë bashkie të PD-së, në bashkitë Kamëz, Mallakastër dhe Shkodër, deklaruan publikisht se nuk do t'i pranonin rezultatet e votimit të 30 qershorit. Në pozicionin e saj si kryetare e Shoqatës Shqiptare të Bashkive, kryetarja aktuale e bashkisë së Shkodrës i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar për të diskutuar angazhimin e tyre të mundshëm në zgjidhjen e situatës. Drejtuesit e PD-së dhe, në një shkallë më të vogël, ata të LSI-së, filluan të kontaktonin kryetarët aktualë të bashkive për të diskutuar hapat e ardhshëm, duke përfshirë edhe dërgimin e një kërkesë pranë gjykatave përkatëse për të mos certifikuar rezultatet e zgjedhjeve për kryetarët e bashkive deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese për kushtetutshmërinë e dekretit të Presidentit të 10 qershorit.¹⁰⁵

XVI. REKOMANDIME

Këto rekomandime, siç jepen edhe përgjatë tekstit, ofrohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të procesit të zhvillimit të zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë dhe për të mbështetur përpjekjet për harmonizimin e tyre me angazhimet e ndërmarra në kuadrin e OSBE-së dhe me detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhet të lexohen së bashku me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it që nuk janë adresuar akoma.¹⁰⁶ ODIHR-i mbetet i gatshëm të asistojë autoritetet e Republikës së Shqipërisë për përmirësimin e mëtejshëm të procesit zgjedhor dhe për adresimin e rekomandimeve që përmban ky dhe raporte të mëparshme të tij.

A. REKOMANDIMET KRYESORE

1. Me qëllim forcimin e demokracisë pluraliste, rikonfirmimin e të drejtës së qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisje dhe demonstrimin e përgjegjësisë së përbashkët për integritetin e procesit zgjedhor, partitë politike dhe aktorët e tjerë zgjedhorë duhet të angazhohen në një dialog të hapur dhe gjithëpërfshirës dhe të lehtësojnë reformën zgjedhore për adresimin e rekomandimeve që përmban ky raport dhe raportet e mëparshme të ODIHR-it.
2. Autoritetet dhe partitë politike duhet të ndërmarrin masa maksimale për eliminimin e problemit të hershëm të shpërdorimit të burimeve administrative në zgjedhje dhe në periudhat midis zgjedhjeve. Autoritetet duhet të nxjerrin rregulla të sakta që përcaktojnë se si mund dhe nuk mund të përdoren burimet publike për qëllime zgjedhore. Hapa të mëtejshëm duhet të merren për arritjen e depolitizimit të shërbimit civil dhe për të garantuar mosushtrimin e presionit ndaj zgjedhësve me qëllim pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të fushatave zgjedhore apo votimin në një mënyrë të caktuar.

¹⁰⁵ PD-ja i mblodhi kryetarët e saj të bashkive në Tiranë në 11 korrik dhe lidhshipi i opozitës filloi një tur në vend për takime në terren me kryetarët e bashkive ende në detyrë.

¹⁰⁶ Sipas paragrafit 25 të [Dokumentit të Stambollit të vitit 1999 të OSBE-së](#), Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan “për të vepruar në mënyrë të menjëhershme në lidhje me vlerësimin e zgjedhjeve nga ODIHR-i dhe për zbatimin e rekomandimeve të tij”. Zbatimi i rekomandimeve të mëparshme vlerësohet nga MVZ-ja e ODIHR-it si vijon: rekomandimi 11 i [raportit përfundimtar të zgjedhjeve parlamentare të 2017-ës](#) (Raporti Përfundimtar i 2017-ës), rekomandimi 6 i [raportit përfundimtar të zgjedhjeve vendore të 2015-ës](#) (Raporti Përfundimtar i 2015-ës), rekomandimet 2, 7, 8 dhe 17 nga [raporti përfundimtar i zgjedhjeve parlamentare të 2013-ës](#) (Raporti Përfundimtar i 2013-ës) si dhe rekomandimet 5, 9, 10, 12, 15, 16, 18, 19 dhe 26 nga [raporti përfundimtar i zgjedhjeve vendore të 2011-ës](#) (Raporti Përfundimtar i 2011-ës) janë zbatuar plotësisht. Rekomandimet 23 nga Raporti Përfundimtar i 2017-ës, 15 dhe 28 nga Raporti Përfundimtar i 2013-ës, si dhe 6, 17, 20 dhe 27 nga Raporti Përfundimtar i 2011-ës janë zbatuar në masën më të madhe. Rekomandimet 3, 4, 10, 12, 16 dhe 18 nga Raporti Përfundimtar i 2017-ës, rekomandimet 2, 8, 10, 14, 18, 20, 21 dhe 23 nga Raporti Përfundimtar i 2015-ës, rekomandimet 1 dhe 9 nga Raporti Përfundimtar i 2013-ës, si dhe rekomandimet 4, 11, 13, 14, 23, 24 dhe 25 nga Raporti Përfundimtar i 2011-ës janë zbatuar pjesërisht. Shih, gjithashtu www.paragraph25.odihhr.pl.

3. Autoritetet duhet të garantojnë të drejtën e zgjedhësve për të zgjedhur në mënyrë të lirë dhe të fshehtë. Procedurat e votimit duhet të rishikohen për të garantuar fshehtësinë e votës dhe mbrojtjen nga çdo ndikim i papërshtatshëm ndaj zgjedhësve. Rëndësia e fshehtësisë së votës duhet të theksohet gjatë trajnimit të komisioneve zgjedhore dhe në materialet e edukimit të zgjedhësve.
4. Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, për të rritur besimin e publikut te procesi zgjedhor, duhet parë mundësia e gjetjes së formulave alternative për propozimin e anëtarëve në administratën zgjedhore, mbështetur me garanci procedurale për pavarësinë e tyre.
5. Të gjitha gjykatat që kanë kompetencë në fushën e zgjedhjeve duhet të jenë plotësisht funksionale gjatë periudhave zgjedhore. Duhet të garantohen pavarësia dhe paanshmëria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e gjyqësorit.
6. Organet e zbatimit të ligjit duhet të hetojnë në mënyrë të plotë, të menjëhershme dhe transparente çdo akuzë për shkelje zgjedhore. Qeveria duhet të përcaktojë një procedurë përmes së cilës punonjës aktualë apo të mundshëm të administratës publike të mund të raportojnë çdo rast presioni politik mbi ta në lidhje me marrjen apo mbajtjen e një posti ose në lidhje me vlerësimin e performancës së tyre në punë. Këta persona duhet të gëzojnë mbrojtjen që ligji ua garanton aktualisht sinjalizuesve.

B. REKOMANDIME TË TJERA

Administrata Zgjedhore

7. Duhet të merren masa efikase për të forcuar më tej metodat e rekrutimit dhe trajnimit të komisionerëve, me qëllim për të garantuar profesionalizmin e tyre. Për rritjen e kapacitetit profesional të komisioneve zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të ofrojë trajnime periodike dhe certifikim të komisionerëve të mundshëm, me qëllim krijimin e një regjistri personash të kualifikuar.
8. Për rritjen e transparencës së punës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të publikojë në kohë dhe në mënyrë sistematike të gjitha vendimet e tij në faqen e tij zyrtare.
9. Autoritetet duhet të marrin një rol proaktiv për garantimin e aksesueshmërisë në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara. Ambientet ku mungon aksesimi duhet të identifikohen kohë më parë dhe, sipas nevojës, duhet të ofrohen zgjidhje alternative.

Regjistrimi i Zgjedhësve

10. Duhet të rishikohen kufizimet e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara mendore dhe për personat që nuk kanë shtetësi shqiptare në zgjedhjet vendore.

Regjistrimi i Kandidatëve

11. Rregullat për regjistrimin dhe tërheqjen e kandidatëve duhet të formulohen saktë dhe zbatimi i tyre nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të orientohet nga parimi i sigurisë juridike.

Fushata Zgjedhore

12. Për parandalimin e toneve të nxehta dhe gjuhës fyese gjatë fushatës, partitë politike dhe subjektet garuese zgjedhore mund të hartojnë dhe t'i përmbahen një kodi të përbashkët etike. Partitë politike duhet të forcojnë zbatimin e kodeve të tyre të brendshme etike, të nxisin demokracinë e brendshme partiake dhe të garantojnë respektimin dhe promovimin e transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit nga strukturat e tyre të brendshme.
13. Duhet të ketë më shumë ndërgjegjësim për rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në jetën publike dhe politike, si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale, duke i mëshuar në mënyrë të veçantë rolit të grave brenda partive politike dhe në proceset zgjedhore.

Financimi i Fushatës

14. Duhet të shihet mundësia e rishikimit të ligjit për të garantuar që KQZ-ja i ka kompetencat dhe procedurat e duhura për të mbikëqyrur dhe për të siguruar zbatimin në mënyrë efikase të rregullave të financimit të partive dhe fushatave.

Media

15. Pavarësia e rregullatorit të medias dhe transmetuesit publik duhet të forcohet më tej përmes masave që parandalojnë konfliktin e interesit. Pozicionet e nivelit të lartë drejtues në transmetuesin publik nuk duhet të jenë të aksesueshme për persona me përkatësi të qarta politike.
16. Ligji për median audiovizive duhet të ndryshohet për të kufizuar në mënyrë efikase përqendrimin e pronësisë së medias në sektorin e transmetimit.
17. Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për t'u garantuar akses të barabartë në media të gjitha partive garuese në të gjitha llojet e programeve editoriale dhe për t'u dhënë mundësi të gjithë garuesve për të blerë hapësira reklamuese në kushte të barabarta. Mund të shihet gjithashtu mundësia për t'u dhënë të gjitha subjekteve zgjedhore një kohë të caktuar falas në mënyrë të barabartë.
18. Përgjegjësitë e BMM-së duhet të përcaktohen qartë. BMM-ja duhet të miratojë në kohën e duhur metodologjinë e monitorimit, dhe të publikojë pa vonesë raportet e saj të monitorimit të medias si dhe vendimet dhe lloje të tjera letrash dhe kërkesash drejtuar medias. BMM-së duhet t'i akordohen burime të mjaftueshme për monitorim më të hollësishëm të medias, duke përfshirë edhe transmetuesit vendorë.
19. Legjislacioni duhet të ndryshohet për të garantuar se mediat janë në gjendje të mbulojnë në mënyrë të pavarur aktivitetet e subjekteve zgjedhore garuese me qëllim kufizimin e përdorimit të përmbajtjes së prodhuar nga vetë partitë politike në edicionet informative dhe për të shmangur keqorientimin e zgjedhësve. Në çdo rast që media përdor përmbajtje të prodhuar nga partitë politike, ajo duhet të etiketohet qartësisht si e tillë.

Ankimet dhe Apelimet

20. Për garantuar transparencën e rezultateve të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore, të gjitha vendimet e Kolegjit Zgjedhor mund të publikohen në mënyrë të menjëhershme dhe të jenë të aksesueshme për të gjithë.

SHTOJCA I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE¹⁰⁷

Numri i zgjedhësve të regjistruar	3,536,016	
Numri i zgjedhësve që votuan	811,727	22.96 përqind
Numri i votave të vlefshme për zgjedhjen e kryetarëve të bashkive	766,482	
Numri i votave të pavlefshme për zgjedhjen e kryetarëve të bashkive	44,263	5.45 përqind
Numri i votave të vlefshme për zgjedhjen e këshillave bashkiakë	761,918	
Numri i votave të pavlefshme për zgjedhjen e këshillave bashkiakë	49,018	6.04 përqind

Rezultatet për zgjedhjen e kryetarëve të bashkive

Subjekti zgjedhor	Numri i vendeve
Aleanca për Shqipërinë Evropiane	60
Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	1

Rezultatet për zgjedhjen e këshillave bashkiakë

Subjekti zgjedhor	Votat e marra		Mandate
	Me shifër	Me përqindje	
Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Evropiane	716,621	94.05	1,555
Partia Socialiste	564,679	74.11	1,136
Partia Socialdemokrate	27,422	3.60	81
Partia Demokracia Sociale	27,865	3.66	79
Partia e Gjelbër	14,246	1.87	35
Partia e Unitetit Kombëtar	10,045	1.32	29
Partia Socialiste e Moderuar	8,682	1.14	25
Partia Aleanca Arbnore Kombëtare	9,513	1.25	24
Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	8,016	1.05	20
Partia Aleanca Demokratike Shqiptare	6,655	0.87	17
Partia Ardhmëria Shqiptare	5,049	0.66	17
Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	4,512	0.59	15
Partia Kristian Demokrate	5,198	0.68	15
Partia G99	4,965	0.65	13
Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	4,680	0.61	11
Partia Socialpunëtore Shqiptare	4,072	0.53	9
Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Evropiane	3,316	0.44	8
Partia e të Drejtave të Mohuara	3,396	0.45	7
Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	1,862	0.24	7
Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet	1,179	0.15	3
Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare	1,018	0.13	3
Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar	251	0.03	1

¹⁰⁷

Burimi: [faqja zyrtare e KQZ-së](#).

Koalicioni Shpresa për Ndryshim	8,615	1.13	12
Partia Ora e Shqipërisë	3,377	0.44	7
Partia Demokracia e Re Evropiane	1,196	0.16	3
Partia Balli Kombëtar	2,387	0.31	2
Partia Bashkimi Liberal Demokrat	1,123	0.15	0
Partia Aleanca Kuq e Zi	340	0.04	0
Partia e Emigracionit Shqiptar	192	0.03	0
Partitë që garuan të vetme	34,716	4.56	50
Partia Bindja Demokratike	20,350	2.67	23
Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	3,028	0.40	13
Fryma e Re Demokratike	8,630	1.13	8
Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Evropian	665	0.09	4
Partia Komuniste e Shqipërisë	1,372	0.18	1
Partia për Mbrojtjen e të Drejt. të Punët. të Shqipërisë	183	0.02	1
Partia Personat me Aftësi të Kufizuar	481	0.06	0
Partia për Liri Demokraci dhe Etikë	7	0.00	0
Partia Kombëtare Konservatore	0	0.00	0
Kandidatë të pavarur	1,966		2

SHTOJCA II: LISTA E VËZHguesVE

Vëzhguesit afatshkurtër të ODIHR-it

Claudia Maria Amry	Austri
Klaus Kapper	Austri
Johannes Payr	Austri
Arno Riedel	Austri
Werner Rohracher	Austri
Margarita Nikolova-Ivanova	Bullgari
Stoyko Yordanov	Bullgari
Petr Piruncik	Republika Çeke
Klara Von Kriegsheim Kadlecova	Republika Çeke
Oldřich Vondruška	Republika Çeke
Ewa Apolonia Chylinski	Danimarkë
Kirsten Joergensen	Danimarkë
Wagn Winkel	Danimarkë
Käthlin Saluveer	Estoni
Maylis De Verneuil	Francë
Nadia Jurzac	Francë
Isabelle Le Guellec	Francë
Loic Tregoures	Francë
Christina Vasak	Francë
Heike Baddenhausen	Gjermani
Peter Besselmann	Gjermani
Katharina Franziska Braig	Gjermani
Christoph Bürk	Gjermani
Ulf Claassen	Gjermani
Kerstin Dokter	Gjermani
Gerda Elisabeth Charlotte Dopheide	Gjermani
Stelian Dumitrache	Gjermani
Frank Fischer	Gjermani
Christoph Hubert Alexander Freiherr Von Feilitzsch	Gjermani
Mendel Goldstein	Gjermani
Enrico Gunther	Gjermani
Dorit Happ	Gjermani
Nicola Hoochhausen	Gjermani
Anke Kerl	Gjermani
Nicole Koenig	Gjermani
Jutta Krause	Gjermani
Daniel Kuehnhenrich	Gjermani
Tina Mede-Karpenstein	Gjermani
Magdalena Metzler	Gjermani
Ulrike Neundorf	Gjermani
Thomas Oye	Gjermani
Oliver Pahnecke	Gjermani
Claudia Preusser	Gjermani
Heinrich Rosendahl	Gjermani
Anca Stan	Gjermani
Pavel Utitz	Gjermani
Peter Vogl	Gjermani
Rebecca Wagner	Gjermani

Heinz Bernd Wittich	Gjermani
Andreas Stergiou	Greqi
Christos Gribas	Greqi
Sarantis Moschovis	Greqi
Michael Gannon	Irlandë
Clíonadh O' Keefe	Irlandë
Brendan O'Shea	Irlandë
Geraldine Power	Irlandë
Vincenzo Alfano	Itali
Francesca Carpinella	Itali
Lorenzo Cugola	Itali
Luigi D'agostino	Itali
Nicoletta Manzini	Itali
Zineb Naini	Itali
Anna Lisa Pantusa	Itali
Chiara Parolin	Itali
Diane Pezzini	Itali
Paolo Zucchi	Itali
Gheorghe Bosii	Moldavi
Valentin Macari	Moldavi
Max Bader	Holandë
Maria Nijenhuis	Holandë
Sellina Van Bruggen	Holandë
Jean Van Der Hoeven	Holandë
Pepijn Zevenhuizen	Holandë
Ilir Islami	Maqedonia e Veriut
Filip Popovski	Maqedonia e Veriut
Alida Boye	Norvegji
Sofie Alexandra Engli Høgestøl	Norvegji
Øystein Moen	Norvegji
Soren Munch	Norvegji
Sven Gunnar Simonsen	Norvegji
Anne Skatvedt	Norvegji
Robert Adam	Rumani
Bogdan Biris	Rumani
Anca Popa	Rumani
Alexandra Visalom	Rumani
Peter Harmanovský	Sllovaki
Evelina Mäsiarová	Sllovaki
Peter Golob	Slloveni
Lorena Diz Conde	Spanjë
Åsa Aguayo Akesson	Suedi
Jan Peter Andersson	Suedi
Paulos Berglöf	Suedi
Irina Bernebring Journiete	Suedi
Sara Louise Julia Lhådö	Suedi
Bengt Mårten Erik Löfberg	Suedi
Dan Thorell	Suedi
Philipp Koller	Zvicër
Adrian Maitre	Zvicër
Jacques Merat	Zvicër
Seda Kirdar	Turqi

Syeda Ali	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Stephen Bouey	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Leonilla Connors	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Harry Edelman	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Timothy Enright	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Alan Friedman	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Carol Fuller	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Gerry Fuller	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kathryn Gest	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Martin Gleason	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Rebecca Graham	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Ana Gutierrez	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
James Heilman	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jordan Kanter	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Marsha Kennedy	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Max Loebel	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Lesia Lozowy	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Nancy Lubin	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Marie-Celeste Marcoux	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Joseph McDonagh	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Joseph Meyer	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Garrett Monti	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Brooke Nagle	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Darcie Nielsen	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kelly Norton	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Hans Opsahl	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Robert Paullin, Jr	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Urania Petit	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Octavius Pinkard	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Marissa Polnerow	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jeannie Schindler	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Steven Smith	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
William Spitznagle	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Mary Stegmaier	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Anne Tara	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Arthur Traldi	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jack Van Valkenburgh	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Roxanne Weiss	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vëzhguesit afatgjatë

Ekipi bërthamë i MVZ-së së ODIHR-it

Audrey Glover	Shefe e Misionit	Mbretëria e Bashkuar
Ahmad Rasuli		Republika Kirgize
Laurentiu Hadirca		Moldavi
Johannes Schmeets		Holandë
Jane Kareski		Maqedonia e Veriut
Stefan Szwed		Poloni
Przemyslaw Wasik		Poloni
Svetlana Chetaikina		Federata Ruse
Ivan Brezina		Slllovakia

Anders Eriksson	Suedi
Egor Tilpunov	Ukrainë
Oleksander Stetsenko	Ukrainë
William Romans	Mbretëria e Bashkuar
Barbara Davis	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së ODIHR-it

Kateřina Duffková	Republika Çeke
Stephanie Marsal	Francë
Evgenia Avetisova	Gjeorgji
Christian Keilbach	Gjermani
Hildegard Rogler-Mochel	Gjermani
James Mc Carthy	Irlandë
Mike Daldossi	Itali
Ilgiz Kambarov	Republika Kirgize
Munkhnaran Bayarlkhagva	Mongoli
Toril Lund	Norvegji
Ivana Krstic	Serbi
Robert Hall	Suedi
Astrid Nunez	Suedi
Zouhal Avzalchoeva	Taxhikistan
Bujar Ajdari	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Andrea Shelley McThomas	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jason Toy	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

RRETH ODIHR-IT

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që asiston Shtetet pjesëmarrëse “për garantimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, për të vepruar në përputhje me shtetin e së drejtës, për të promovuar parimet e demokracisë dhe (...) për të ndërtuar, forcuar dhe mbrojtur institucionet demokratike, si dhe për të promovuar tolerancën në të gjithë shoqërinë” (Dokumenti i Samitit të Helsinkit i vitit 1992). Kjo është ajo çka njihet si dimensionin njerëzor i OSBE-së.

ODIHR-i, me seli në Varshavë (Poloni) është krijuar si Zyra për Zgjedhje të Lira në Samitin e Parisit të vitit 1990 dhe ka filluar të funksionojë në maj të vitit 1991. Një vit më pas, emri i kësaj zyre u ndryshua për të pasqyruar mandatin e zgjeruar, i cili do të përfshinte edhe të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot, ai punëson më shumë se 150 punonjës.

ODIHR-i është agjencia lider në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Çdo vit, ai koordinon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar nëse zgjedhjet në rajonin e OSBE-së kryhen në përputhje me angazhimet e OSBE-së, detyrime të tjera ndërkombëtare dhe standardet për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas. Metodologjia e tij unike ofron një analizë të thelluar të proceseve zgjedhore në tërësinë e tyre. Përmes projekteve të tij të asistencës, ODIHR-i i ndihmon Shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin e tyre zgjedhor.

Aktivitetet e kësaj zyre në fushën e **demokratizimit** përfshijnë: shtetin e së drejtës, mbështetjen legjislative, qeverisjen demokratike, migrimin dhe lirinë e lëvizjes, si dhe barazinë gjinore. ODIHR-i zbaton çdo vit një sërë programesh asistence me objektiva të specifikuar, në përpjekje për zhvillimin e strukturave demokratike.

ODIHR-i i ndihmon gjithashtu Shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e detyrimeve të tyre për promovimin dhe mbrojtjen e **të drejtave të njeriut dhe lirive themelore** në përputhje me angazhimet e OSBE-së në dimensionin njerëzor. Kjo arrihet duke punuar me një sërë partnerësh për forcimin e bashkëpunimit, ndërtimin e kapaciteteve dhe ofrimin e ekspertizës në fusha tematike, duke përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, edukimit dhe trajnimit në lidhje me të drejtat e njeriut, monitorimit dhe raportimit për të drejtat e njeriut, si dhe të drejtat e njeriut të grave dhe fushën e sigurtisë.

Në fushën e **tolerancës dhe mosdiskriminimit**, ODIHR-i u ofron mbështetje Shteteve pjesëmarrëse në forcimin e kundërpërgjigjes së tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe rasteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të mungesës së tolerancës. Aktivitetet e ODIHR-it në lidhje me tolerancën dhe mosdiskriminimin fokusohen në këto fusha: legjislacion; trajnime për zbatimin e ligjit; monitorim; raportim dhe ndjekje e reagimeve ndaj krimeve të urrejtjes dhe rastet specifike; si dhe aktivitetet edukuese për promovimin e tolerancës, respektimit dhe mirëkuptimit reciprok.

ODIHR-i u ofron këshillim Shteteve pjesëmarrëse për politikatat e tyre në lidhje me **romët dhe sintit**. Ai promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin në rrjet mes komuniteteve romë dhe sinti, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve të romë dhe sinti në organet vendimmarrëse.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it kryhen në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet e OSBE-së dhe misionet e saj në terren, si dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të ODIHR-it (www.osce.org/odihr).